



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

**PËR PUNËN E ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

**PËR PERIUDHËN
01.01.2024 – 31.12.2024**

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	4
1.1.	Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë.....	5
II.	KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË	7
2.1	Referenca Ligjore	7
2.2	Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	8
2.2.1	Akte lidhur me organizimin dhe funksionimin	9
2.2.2	Akte lidhur me veprimtarinë inspektuese.....	10
III.	VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET	13
3.1.	Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	13
3.1.1	Të dhënat e ankuesit	14
3.1.2.	Të dhëna për subjektin ndaj të cilit ngrihen pretendime.....	14
3.2	Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave	17
3.2.1	Shqyrtimi i ankesave	17
3.2.2	Vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	18
3.3	Hetimet Disiplinore	22
3.4	Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit	24
3.5	Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave	24
3.6	Inspektimet Tematike.....	26
3.6.1	Ecuria e Inspektimeve tematike.....	26
3.6.2	Rekomandimet e inspektimeve	29
3.6.3	Monitorimi i rekomandimeve.....	30
3.7	Analiza e shqyrtimit të ankesave dhe inspektimeve.....	31
3.7.1	Mbi shqyrtimin e ankesave	31
3.7.2.	Mbi ankimet ndaj vendimeve të arkivimeve dhe mbylljes së hetimeve.....	34
3.7.3	Mbi hetimin disiplinor	35
3.7.4	Mbi kërkesat për procedim disiplinor	35
3.7.5	Mbi inspektimet	36
IV.	BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR^{II}	38
4.1	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - KLGJ/KLP/KPK.....	38
4.2	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Prokurorin e Përgjithshëm ..	40

4.3	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrin e Drejtësisë	40
4.4	Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile	40
4.5	Marrëveshje bashkëpunimi dhe aktivitete nga marrëveshjet.....	42
4.6	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë	43
4.7	Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, në kuadër të procesit për integrimin evropian.....	47
V	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	49
5.1	Komandime nga KLGJ	49
5.2	Komandime nga KLP	49
5.3	Rekrutim i inspektorëve jomagjistratë	50
5.4	Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore	51
5.5	Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve	52
VI	TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE	55
6.1	Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.....	55
6.2	Procese gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	55
6.3	Procese gjyqësore të përfunduara apo në fazë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	56
VII	TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN ^{II}	58
7.1	Qytetari i informuar në vëmendje të ILD-së.....	58
7.2	Pritja e qytetarëve në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	59
7.3	E drejta e informimit.....	59
7.4	Komunikimi i targetuar publik.....	60
7.4.1	Faqja zyrtare e internetit	60
7.4.2	Komunikimi me masmedian	61
7.4.3	Rrjetet sociale	62
7.5	Edukimi ligjor si mënyrë direkte komunikimi	62
VIII	PERFORMANCA FINANCIARE	63
IX.	PËRMBLEDHJE TË ARRITJEVE	65
X	NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2023.....	67

I. HYRJE

Ky raport vjetor përmbledh aktivitetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) për periudhën Janar-Dhjetor 2024, duke analizuar shqyrtimin dhe verifikimin e ankesave, hetimet disiplinore, procedimet disiplinore, inspektimet tematike, performancën si institucion publik, si dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Aktiviteti i ILD-së ka ndjekur një rrugëtim progresiv, duke kaluar nga ngritja dhe konsolidimi i proceseve në forcimin e inspektimeve, me qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Në këndvështrimin e ILD -së, inspektimet nuk shërbejnë vetëm për kontrollin e llogaridhënies së magjistratëve, por gjithashtu ndihmojnë në rritjen e performancës së sistemit gjyqësor dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Në këtë kuadër, raporti evidenton të dhënat mbi numrin e ankesave të depozituara, vendimet e marra nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe ecurinë e inspektimeve tematike. Gjatë vitit 2024:

- 1374 ankesa janë trajtuar;
- 25 magjistratë janë hetuar;
- 11 procedime disiplinore janë ndërmarrë;
- 23 hetime disiplinore janë kryer;
- 6 inspektime tematike janë përfunduar.

Përmes hetimeve disiplinore dhe procedurave të ndjekura është vërejtur një rritje e standardeve të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të rekomandimeve.

Në aspektin e bashkëpunimit institucional dhe ndërkombëtar, raporti reflekton mbi marrëdhëniet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me institucionet kyçe të drejtësisë, përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dhe me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një tjetër mënyrë e vlerësimit të jashtëm të punës së ILD-së vjen nga institucionet ndërkombëtare, të cilat në Progres Raportin¹ për Shqipërinë 2024 kanë evidentuar kontributin e ILD-së në forcimin e llogaridhënies së magjistratëve, duke vënë theksin tek funksionimi i kënaqshëm i ILD-së dhe progresi i mirë i vazhdueshëm në zbatimin e reformave në drejtësi kanë forcuar përgjegjshmërinë në të gjithë sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, vlerësimet kanë

¹ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8ecc3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf faqe 29-30

nënvizuar përfundimin e shqyrtimit të fondit të ankesave të trashëguara (backlog) dhe nevojën për të vijuar me fuqizimin e inspektimeve tematike, si një prioritet kyç për rritjen e transparencës dhe efektivitetit të sistemit.

Sa i përket rritjes së kapaciteteve, theksi kryesor është vendosur te trajnimi i Njësisë së Inspektorëve dhe asaj të Ndhmës Inspektorëve me ekspertë të huaj, të cilët kanë sjellë përvojat më të mira ndërkombëtare për inspektimin dhe kontrollin disiplinor. Përveç kësaj janë ndjekur edhe trajnime të ofruara nga ASPA dhe Shkolla e Magjistraturës, duke mbështetur zhvillimin profesional të stafit në të gjitha nivelet.

Në përputhje me parimet e transparencës dhe komunikimit me publikun, ILD ka vijuar të promovojë informimin e qytetarëve, transparencën dhe rritjen e aksesit në institucion. Edukimi ligjor është vënë në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat dhe detyrimet e individëve, duke synuar një administrim më të drejtë dhe efikas të drejtësisë.

Si konkluzion, raporti reflekton fokusin e ILD-së, në veprimtari që ndihmojnë në rritjen e performancës së sistemit të drejtësisë, adresimin e çështjeve që lidhen me efikasitetin e sistemit të drejtësisë, përhithjen e standardeve më të larta të procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, rritjen profesionale të trupës së inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve, si dhe rritjen e komunikimit publik mbi rolin e ILD-së brenda dhe jashtë vendit.

1.1. Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e sistemeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare si dhe nga fryma që inspiroi ngritjen dhe vënien në funksion të sistemit të ri të Drejtësisë. Ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur ndaj çdolloj ndikimi duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe kompetencave të dhëna me ligj, ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme, llogaridhënese, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore, me efikasitet dhe profesionalizëm, të besueshme, transparente dhe të aksesueshme prej publikut, si dhe bashkëpunuese në nivel institucional, janë kolonat e vendosura nga Reforma ndaj të cilave Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duhet të referojnë në çdo rast të shtruar për zgjidhje.

Nën dritën e vizionit të veprimtarisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, drejton punën me synim arritjen e këtyre objektivave të rëndësishme:

- Konsolidimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale;
- Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane;
- Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit;

- Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për qëllime të zbatimit në praktikë të objektivave të punës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar strukturën organizative të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e cila është konceptuar për të funksionuar në respektim të parimeve të hierarkisë, llogaridhënies, ligjshmërisë, efektivitetit, paanësisë dhe mosdiskriminimit si dhe të bashkëpunimit, në përmbushjen e misionit Kushtetues e ligjor për të arritur objektivat e sipërpërmendura.

II. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

2.1 Referenca Ligjore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147/d të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Organizimi dhe funksionimi i institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 536, datë 25.07.2019, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”;
- Vendimi nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave, të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbështetet midis të tjerash në:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të

- detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
 - Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar,
 - Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
 - Ligjin për buxhetin vjetor;
 - Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
 - Ligjin nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;
 - Vendimin nr. 972, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin të kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”;
 - Vendimin nr. 971, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë”;
 - Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme”.

2.2 Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore, për nxjerrjen e urdhrave të përgjithshëm me natyrë administrative ose procedurale, janë hartuar dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të gjitha aktet e nevojshme për funksionimin e strukturës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në nivel të organizimit administrativ. Në total janë miratuar 30 akte, prej të cilave 17 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ dhe 2 vendime që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit^[2].

Krahas urdhrave dhe vendimeve të përgjithshëm, janë hartuar edhe 7 vendime në funksion të miradministrimit të proceseve inspektuese si dhe 6 vendime ndryshuese të tyre.

Sa i takon urdhrave të përgjithshëm administrativë dhe vendimeve, ndër më të rëndësishmet, rendisim sipas kategorive:

² Urdhrat janë të aksesueshëm në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

- Organizim dhe funksionim,
- Veprimtaria inspektuese.

2.2.1 Akte lidhur me organizimin dhe funksionimin

1. Urdhër nr. 136/1, datë 05.01.2024, për një ndryshim në urdhrin nr. 136, datë 27.12.2023 “Për përbërjen e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit, caktimin e anëtarëve të sekretariatit teknik, miratimin e programit vjetor të vlerësimit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit të inspektorëve”;
2. Vendim nr. 3, datë 15.01.2024 “Për përcaktimin e pozicioneve pjesë e shërbimit civil që do të shpallen për vitin 2024, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
3. Urdhër nr. 1, datë 08.01.2024 “Për njësimin e dokumentit administrativ”;
4. Urdhër nr. 26, datë 06.03.2024 “Për zëvendësimin e punës së datës 27.11.2023”;
5. Urdhër nr. 36, datë 28.03.2024 “Për rishpërndarjen e praktikave në fazë shqyrtimi fillestar inspektorit znj. D. S.”;
6. Urdhër nr. 38, datë 29.03.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022 “Për caktimin e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”;
7. Urdhër nr. 1/1, datë 30.04.2024, “Për një shtesë në urdhrin nr. 1, datë 08.01.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për njësimin e dokumentit administrativ””;
8. Urdhër nr. 71, datë 13.06.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e aktiviteteve për shënjimin e 5-vjetorit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
9. Urdhër nr. 72, datë 18.06.2024 “Për zëvendësimin e ditës së punës së datës 15.03.2024”;
10. Urdhër nr. 74, datë 26.06.2024 “Për fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
11. Urdhër nr. 75, datë 01.07.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”;

12. Urdhër nr. 77, datë 10.07.2024 “Për shpërndarjen e praktikave të dorëzuara nga inspektori A. T.”;
13. Urdhër nr. 80, datë 03.08.2024 “Për delegimin e kompetencës”;
14. Urdhër nr. 91, datë 08.10.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”;
15. Vendim nr. 56, datë 10.12.2024 “Për disa shtesa në vendimin në. 38, datë 08.06.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”, të ndryshuar”;
16. Urdhër nr. 74/1, datë 16.12.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 74, datë 26.06.2024 “Për fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””;
17. Urdhër nr. 107, datë 16.12.2024 “Për miratimin e “Regjistratit të riskut për sistemet e teknologjisë së informacionit” dhe “Manualit për masat e sigurisë së sistemeve të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
18. Urdhër nr. 118, datë 31.12.2024 “Për ngritjen e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit, caktimin e anëtarëve të Sekretariatit Teknik dhe fillimin e procedurës së vlerësimit të inspektorëve për periudhën 2021-2025”;
19. Urdhër nr. 119, datë 31.12.2024 “Për ngritjen e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

2.2.2 Akte lidhur me veprimtarinë inspektuese

1. Vendim nr. 5, datë 31.01.2024 “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2024”;
2. Vendim nr. 6/13, datë 15.02.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/2, datë 28.02.2023 “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive me objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori”, të ndryshuar”;
3. Vendim nr. 7, datë 15.02.2024 i inspektimit tematik me objekt: “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”;

4. Vendim nr. 10, datë 29.02.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/5, datë 30.06.2023 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”, të ndryshuar”;
5. Vendim nr. 7/1, datë 29.03.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 7, datë 15.02.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023””.
6. Vendim nr. 14, datë 02.04.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023””;
7. Vendim nr. 18, datë 15.04.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile, për periudhën 01.03.2023 – 31.05.2023””;
8. Vendim nr. 21, datë 15.05.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023””;
9. Vendim nr. 22, datë 15.05.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023””;
10. Vendim nr. 23, datë 15.05.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023””.
11. Vendim nr. 22/1, datë 27.11.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 22, datë 15.05.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023””;
12. Vendim nr. 14/1, datë 27.12.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 14, datë 02.04.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023””;

13. Vendim nr. 18/1, datë 27.12.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 18, datë 15.04.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, me palë kundërshtare, të përfunduara gjatë periudhës kohore 01.03.2023-31.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile””.

III. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET

3.1. Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Pjesës V, Kreu II, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për:

- verifikimin e ankesave;
- hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm;
- si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Referuar veprimtarisë dhe në funksion të përmbushjes së parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2024, vihet re një numër në rritje ankesash të depozituara, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Gjatë këtij viti janë depozituar **1491** ankesa të reja të cilat të shpërndara sipas subjekteve ankuese janë:

- **1376** ankesa të depozituara nga persona fizikë;
- **115** ankesa të depozituara nga persona juridikë.

Në mbyllje të vitit 2023 janë mbartur për trajtim **1363** ankesa. Objekt shqyrtimi për vitin 2024 në total janë **2854** ankesa, duke përfshirë dhe ankesat e depozituara gjatë këtij viti (**1491**).

Nga këto, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2024 ka shqyrtuar **1374** ankesa.

Tabela nr. 1. Të dhënat mbi ankesat për vitin 2024

Ankesa të depozituara gjatë vitit 2024	Ankesa të mbartura nga viti 2023	Ankesa objekt shqyrtimi gjatë vitit 2024	Ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2024	Ankesa të mbartura për vitin 2025
1491	1363	2854	1374	1480

Sipas të dhënave të ecurisë së shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, në përfundim të vitit 2024 rezulton se mbeten në proces **1,480** ankesa, që do të mbarten për trajtim në vitin 2025.

Rezultati i shqyrtimit të **1374** ankesave është si në vijim:

- **993** ankesa të arkivuara pas shqyrtimit fillestar;
- **327** ankesa të arkivuara pas verifikimit^[3];
- **54** ankesa të përfunduara me hetim disiplinor.

Nga **1374** ankesa të shqyrtuara rezulton se:

- **1246** ankesa janë depozituar nga persona fizikë;
- **127** ankesa janë depozituar nga persona juridikë, përkatësisht:
 - **64** ankesa nga institucione publike;
 - **44** ankesa nga subjekte private;
 - **15** ankesa nga fondacione dhe organizata të shoqërisë civile;
 - **2** ankesa nga media;
 - **2** ankesa nga institucione fetare;
- **1** ankesë anonime, pasi nuk evidentohet emri i ankuesit.

3.1.1 Të dhënat e ankuesit

Ankuesit të cilët i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë një përfaqësim gjeografik nga i gjithë vendi, ku peshën më të madhe e ka qarku i Tiranës me 284 ankues (36% të ankuesve), ndjekur nga qarku Vlorë dhe qarku Durrës, respektivisht 91 dhe 81 ankues (12% dhe 10% të ankuesve). Ndërsa qarqet të cilat shënojnë numrin më të ulët të ankuesve janë qarku Dibër, qarku Gjirokastrë dhe qarku Kukës, respektivisht me 16, 19 dhe 10 ankues (2%, 2% dhe 1% të ankuesve).

Nga analiza e informacionit lidhur me regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, vihet re se 576 ankues (74%) kanë depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm 1 ankesë, ndërsa 189 ankues (24%) kanë depozituar më shumë se një ankesë, për të njëjtin subjekt.

3.1.2. Të dhëna për subjektin ndaj të cilit ngrihen pretendime

Ankuesit kanë depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë Drejtësisë ankesa, duke ngritur pretendime ndaj subjekteve magjistratë gjyqtarë dhe prokurorë. Nga 1374 ankesa të shqyrtuara, rezulton se pretendimet janë paraqitur në masën:

- **642** ankesa për magjistratë gjyqtarë (47%);
- **357** ankesa për magjistratë prokurorë (26%);

³ Te numri i ankesave të arkivuara pas verifikimit, përfshihen edhe ankesat për të cilat ILD ka disponuar me përfundim procedure verifikimi pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 95 të Kodit të procedurave administrative.

- 284 ankesa për gjyqtarë dhe prokurorë së bashku (21%);
- 91 ankesa (7%) nuk identifikohet subjekti ndaj të cilit ngrihen pretendime.

Tabela nr. 2. Të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të shqyrtuara sipas institucionit ku ushtron detyrën magjistrati (Gjyqësori)

Nr	Institucioni	Ankesa të shqyrtuara sipas institucionit ku ushtron detyrën magjistrati	Raporti në përqindje për ankesat e shqyrtuara
1	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	208	15%
2	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	168	12%
3	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	73	5%
4	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	64	5%
5	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	56	4%
6	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	54	4%
7	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	50	4%
8	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	49	3%
9	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	48	3%
10	Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	44	3%
11	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	33	2%
12	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	32	2%
13	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë	30	2%
14	Gjykata Administrative e Apelit	27	2%
15	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	25	2%

16	Gjykata e Lartë	24	2%
17	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO)	12	1%
18	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	6	0.4%
19	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	5	0.3%
20	Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	1	0.07%

Tabela nr. 3. Të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të shqyrtuara sipas institucionit ku ushtron detyrën magjistrati (Prokuroria)

Nr	Institucioni	Ankesa të shqyrtuara sipas institucionit ku ushtron detyrën magjistrati	Raporti në përqindje për ankesat e shqyrtuara
1	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	201	14%
3	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	62	5%
4	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	51	4%
5	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës	46	3%
6	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	41	3%
7	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier	40	3%
8	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	40	3%
9	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)	25	2%
10	Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	34	2%
11	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	28	2%

12	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	24	2%
13	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë	20	1%
14	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	16	1%
15	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	13	1%
16	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë	4	0.2%

3.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave

3.2.1 Shqyrtimi i ankesave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të paragrafit 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë për të cilën, vendoset arkivimi i saj, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk përmbushen. Sipas nenit 122 të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar, apo duke marrë çdo informacion tjetër nga Këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Nisur nga shqyrtimi i objektit të ankesave, rezulton se problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit, sipas peshës që kanë në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave, janë si më poshtë:

- Pretendime që lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave dhe vlerësimit të provave nga gjykata respektive;
- Pretendime për vonesa në shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- Pretendime për kryerjen e veprimeve/moskryerjen e veprimeve hetimore, apo vlerësimin e provave të grumbulluara nga organi hetimor gjatë procesit hetimor;
- Ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve;
- Pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarëve por edhe zvarritje të veprimtarisë hetimore nga prokurorët;

- Pretendime për papajtueshmëri apo konflikt interesi;
- Pretendime për shkelje të etikës nga magjistratët.

Referuar numrit të ankesave të shqyrtuara në të cilat evidentohet lloji i procesit gjyqësor rezultojnë këto të dhëna:

Tabela nr. 4. Numri i ankesave sipas llojit të çështjeve

Lloji i çështjeve	Numër ankesash
Çështje Penale	783
Çështje Civile	385
Çështje Administrative	103
Të tjera (ku nuk evidentohet lloji i procesit gjyqësor)	103

3.2.2 Vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në përmbushje të parashikimeve ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit të ankesave ka miratuar **970** vendime, nga të cilat:

- 568** vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, ku janë shqyrtuar **993** ankesa;
- 190** vendime për arkivimin pas verifikimit⁴, ku janë shqyrtuar **327** ankesa;
- 23** vendime për hetim disiplinor ndaj **25** magjistratëve:
 - 13 vendime për hetim disiplinor ndaj 14 magjistratëve, ku janë shqyrtuar 54 ankesa;
 - 10 vendime hetimi disiplinor ndaj 11 magjistratëve, të nisura me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë gjatë vitit 2024 edhe 189 vendime për verifikimin e 277 ankesave prej të cilave, 158 vendime verifikimi janë mbi bazë ankese dhe 31 vendime për verifikimin me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit një pjesë e ankesave janë arkivuar me vendim arkivimi të përllogaritura në germën “b” dhe pjesa tjetër është në proces verifikimi.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë si organ kompetent për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë, bazuar në pikën 2, të nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ka marrë

⁴ Verifikime të nisura gjatë vitit 2024 dhe vitet e mëparshme.

në shqyrtim dhe verifikim edhe ankime nga subjekte të posaçme. Në zbatim të këtij parashikimi kanë paraqitur ankim me shkrim kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive ndaj magjistratëve që ushtrojnë detyrën në këto institucione. Ankime me shkrim ka pasur edhe nga organe të tjera, që sipas dispozitave të veçanta dhe funksioneve të tyre, mbartin detyrimin për të transferuar raste apo për të paraqitur ankim me shkrim për verifikim të mëtejshëm kur evidentojnë shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore. Subjektet që kanë përcjellë ankime, renditen si vijon:

Të dhëna për ankimet nga kryetarët e gjykatave:

Për vitin 2024, një kryetar gjykate ka përcjellë gjithsej 2 ankime në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ecuria e të cilave gjendet e pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 5. Ecuria e trajtimit të ankimeve të përcjella nga kryetarët e gjykatave

Ankime gjithsej të kryetarëve të gjykatave	Vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar	Vendime arkivimi pas verifikimit	Vendime për fillim të hetimit disiplinor	Në proces
2	-	-	1	1

Të dhëna për ankimet nga drejtuesit e prokurorive:

Tre drejtues të prokurorive kanë përcjellë gjithsej 20 ankime në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ecuria e të cilave gjendet e pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 6. Ecuria e trajtimit të ankesave të përcjella nga drejtuesit e prokurorive

Ankime gjithsej të drejtuesve të prokurorive	Vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar	Vendime verifikimi	Vendime për fillim hetimi disiplinor	Vendim për përfundim verifikimi pa një vendim përfundimtar	Në proces
20	1	2	2	1	8

Nga 3 (tri) drejtues të prokurorive gjatë vitit 2024, ka 20 ankime të depozituara, respektivisht **1 Drejtues 12 ankime, 1 Drejtues 1 ankim dhe 1 Drejtues 7 ankime**. Për këto ankime rezultatet e trajtimit janë si vijon:

1. **Për 12 ankime**, 1 ankim është në proces dhe janë trajtuar me 3 vendimmarrje 11 ankimet e tjera, konkretisht:

- arkivim për një pjesë të pretendimeve;
 - verifikimi për një pjesë të pretendimeve;
 - fillim hetimi disiplinor për pjesën tjetër të pretendimeve.
2. **Për 1 ankim** Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor.
 3. Ndërsa **7 ankime** mbeten në proces.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, ILD ka trajtuar me vendimmarrje edhe 2 ankime të paraqitura në periudhë të mëparshme, nga 1 drejtues prokurorie, konkretisht:

- Ka nisur verifikim për 1 ankim i cili mbetet në proces;
- Ka përfunduar verifikimi pa një vendim përfundimtar për ankimin tjetër.

Të dhëna nga referimet e transferuara nga KPK

Nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë përcjellë në institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2024 gjithsej 2 raste. Ecuria e trajtimit të rasteve të paraqitura në periudha ndër vite por të trajtuara gjatë vitit 2024, gjendet e pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 7. Ecuria e trajtimit të rasteve të transferuara nga KPK

Raste të transferuara në vitin 2024 nga KPK	Raste të trajtuara gjatë vitit 2024			Në proces
	Vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar	Vendime arkivimi pas verifikimit	Vendime për fillim të hetimit disiplinor	
2	7	1	2	1

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga 2 rastet e përcjella gjatë vitit 2024 ka filluar hetimin disiplinor për 1 rast dhe rasti tjetër është në proces. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me vendimmarrje edhe 9 raste të transferuara në periudha të mëparshme, nga KPK, për të cilat ka vendosur:

- Fillimin e hetimit disiplinor dhe ka dërguar kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor për 1 rast;
- Arkivimin pas shqyrtimit fillestar për 7 raste;
- Arkivimin pas verifikimit për 1 rast.

Të dhëna nga vendimet e Gjykatës së Lartë:

Rëndësi i është kushtuar edhe trajtimit të rasteve të përcjella nga Gjykata e Lartë në kuadër të gjykimit të kërkesave, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit. Gjykata

e Lartë ka përcjellë gjithsej 4 vendimmarrje gjatë vitit 2024, ku ka gjykuar kërkesat për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm. Ecuria e trajtimit të rasteve të paraqitura në periodha ndër vite por të trajtuara gjatë vitit 2024, gjendet e pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 8. Ecuria e trajtimit të rasteve të përcjella nga Gjykata e Lartë

Raste të përcjella në vitin 2024 nga Gjykata e Lartë	Raste të trajtuara gjatë vitit 2024			Në proces
	Vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar	Vendime arkivimi pas verifikimit	Vendim për përfundim verifikimi pa një vendim përfundimtar	
4	26	2	1	4

Katër rastet e përcjella nga Gjykata e Lartë janë në proces. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me vendimmarrje edhe 29 raste të ardhura nga Gjykata e Lartë në periodha të mëparshme, për të cilat ka vendosur:

- arkivimin pas shqyrtimit fillestar për 26 raste;
- arkivimi pas verifikimit për 2 raste;
- përfundim verifikimi pa një vendim përfundimtar për 1 rast.

Tabela nr. 9. Ecuria e trajtimit të ankimeve të Prokurorit të Përgjithshëm

Ankime të Prokurorit të Përgjithshëm	Vendime arkivimi pas verifikimit	Raste në proces
-	1	0

Gjatë vitit 2024 nga Prokurori i Përgjithshëm nuk ka ankime të depozituara. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me vendimmarrje 1 ankim të paraqitur në periodha të mëparshme, nga Prokurori i Përgjithshëm, konkretisht ka vendosur arkivimin pas verifikimit të ankimit.

Tabela nr. 10. Ecuria e trajtimit të ankimeve të ministrit të Drejtësisë

Ankime gjithsej të ministrit të Drejtësisë	Vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar	Vendime arkivimi pas verifikimit dhe përfundimin e verifikimit pa një vendim përfundimtar	Vendime për fillim hetimi	Raste në proces
-	1	1	1	0

Gjatë vitit 2024 nga Ministri i Drejtësisë, nuk ka ankime të depozituara. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me vendimarrje 2 ankime të paraqitura në periudha të mëparshme, konkretisht ka vendosur:

- Për 1 ankim është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar për një magjistrat.
- Për 1 ankim, në të cilin ngrihen pretendime për 6 magjistratë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur:
 - për 2 magjistratë ka vendosur arkivimin pas verifikimit, pasi nuk ka pasur shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit;
 - për 3 magjistratë, ka përfunduar verifikimin pa një vendim përfundimtar pasi objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur verifikimi është bërë i pamundur, për shkak se magjistratët kishin humbur statusin e tyre;
 - për 1 magjistrat ka filluar hetimi disiplinor.

3.3 Hetimet Disiplinore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativë, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi konstatoi ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme, ka miratuar **23** vendime për hetim disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së **25** subjekteve. Hetimi disiplinor për **14** subjekte ka filluar mbi bazë ankese dhe për **11** subjekte ka filluar me iniciativë. Gjithashtu ILD ka vijuar edhe me hetimet e filluara nga viti 2023.

Gjatë vitit 2024, nga hetimet e nisura me iniciative në dy raste Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer edhe hetime pasurore, nisur nga të dhënat e denoncuar në publik.

Të dhënat për hetimet e filluara janë si vijon:

- Për 5 magjistratë (3 gjyqtarë dhe 2 prokurorë) janë paraqitur pranë Këshillave respektivë kërkesat për procedim;
- Për 3 magjistratë dhe 1 anëtar Këshilli është mbyllur hetimi disiplinor (për një magjistrat hetimi ka filluar në vitin 2023);
- Për 17 magjistratë (10 gjyqtarë dhe 7 prokurorë) të hetimit disiplinor, procedurat hetimore mbeten në proces.

Tabela nr. 11. Hetimet disiplinore për vitin 2024

Hetimet sipas subjekteve				
Numri i subjekteve të hetuara				
25				
Prokurorë	Gjyqtarë	Anëtarë Këshilli	Hetime mbi bazë ankese në ILD	Hetime me iniciativë ILD
11	13	1	14	11

Hetimi disiplinor për 25 subjekte të hetimit disiplinor ka filluar pas dyshimeve të arsyeshme se shkelja e pretenduar mund të jetë kryer. Shkeljet disiplinore për të cilat institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor, lidhen me shkelje disiplinore^[5] në ushtrimin e funksionit, të cilat renditen:

- Për veprim, mosveprim ose sjellje të magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin, të parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për 8 raste;
- Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për 6 raste;
- Mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit, të parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për 4 raste;
- Mosparaqitje të kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni

⁵ Në disa raste një subjekt është hetuar për më tepër se një shkelje disiplinore.

të rrethanave të tilla; të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për 2 raste;

- Shkelje të tjera^[6], 20 raste.

3.4 Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit

Bazuar në nenin 119, pika 4 dhe nenin 122, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në Këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës. Neni 62, pika 13 dhe neni 160, pika 13 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikojnë respektivisht të drejtën për ankim ndaj vendimeve të arkivimit ose të pushimit/mbylljes së hetimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pranë Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve, që ngrihet respektivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendimet e Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit.

Gjatë vitit 2024 ILD ka marrë 762 vendime objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme të Shqyrtimit të Ankimeve, nga ku rezulton se kundër vendimeve janë ankimuar vetëm 89 vendime:

- 68 ankime ndaj 568 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- 21 ankime ndaj 190 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;
- asnjë ankim ndaj 3 vendimeve për mbylljen e hetimit disiplinor, të filluar mbi bazë ankese.

3.5 Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas vlerësimit të provave të mbledhura dhe kur rezultatet e hetimit çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor pranë Këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

⁶ Neni 102, pika 1, shkronjat “c”, “e”, “ë” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, - 6 raste.

Neni 102, pika 2, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 - 2 raste.

Neni 102, pika 1, shkronjat “b”, “g”, “i”, “j”, “p” të ligjit nr. 96/2016 - 5 raste.

Neni 103, shkronjat “a”, “b”, “dh” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, - 4 raste.

Neni 140, pika 2, shkronjat “a”, “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, - 1 rast.

Neni 319/ç i Kodit Penal, - 1 rast.

Neni 103/1/k i ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, - 1 rast.

Gjatë vitit 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 11 magjistratë, për 6 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 5 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në shkeljet disiplinore të parashikuar nga nenet 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neni 140 i “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si:

- Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;
- Mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla;
- Shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- Përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;
- Veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;
- Shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore;
- Për rastet kur gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur ^{6[7]} kërkesa për procedim disiplinor në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke propozuar këto masa disiplinore:

- “Shkarkim nga detyra” - 6 raste.

Nga shqyrtimi në Këshillin e Lartë Gjyqësor rezulton se:

- 2 kërkesa për procedim disiplinor janë pranuar;
- 1 kërkesë për procedim disiplinor është rrëzuar;
- 1 kërkesë për procedim disiplinor është pezulluar;

⁷ Për 3 magjistratë Gjyqtar hetimi disiplinor ka filluar në vitin 2023

- 2 kërkesa për procedim disiplinor janë në proces.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur 5^[8] kërkesa për procedim disiplinor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, duke propozuar këto masa disiplinore:

- “Vërejtje konfidenciale” – 2 raste;
- “Ulje e përkohshme e pagës deri në masën 40% për një periudhë njëvjeçare” – 3 raste.

Nga shqyrtimi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë rezulton se:

- 1 kërkesë për procedim disiplinor është pranuar me ndryshim mase: nga “Ulje e përkohshme e pagës deri në masën 40% për një periudhë një vjeçare” në “Vërejtje Publike”;
- 2 kërkesa për procedim disiplinor janë rrëzuar;
- 2 kërkesa për procedim disiplinor janë në proces.

Tabela nr. 12. Dinamika e masave disiplinore të propozuara nga ILD për vitin 2024

Masa disiplinore e propozu nga ILD	Numri i kërkesave për procedim disiplinor	Magjistrati	
		Gjyqtar	Prokuror
Shkarkim nga detyra	6	6	0
Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit	3	0	3
Vërejtje konfidenciale	2	0	2
Totali	11	6	5

3.6 Inspektimet Tematike

3.6.1 Ecuria e Inspektimeve tematike

Në mbështetje të nenit 194, pikës 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka në objekt të veprimtarisë së tij, ndër të tjera, kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike në lidhje me çdo aspekt të

⁸ Për 3 magjistratë prokuror hetimi disiplinor ka filluar në vitin 2023

punës së gjykatave, të administratës gjyqësore, zyra të prokurorive dhe administratës së prokurorive.

Sipas traditës së krijuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë edhe për vitin 2024 u është drejtuar institucioneve të përcaktuara në nenin 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me kërkesë për të përcjellë tematika inspektimi. Referuar korrespondencës së ardhur rezultojnë këto të dhëna:

- Prokurori i Përgjithshëm ka propozuar ndërmarrjen e inspektimeve sa i takon:
 - Respektimit të të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimave të krimeve seksuale dhe dhunës në familje;
 - Zbatimit të masës së shmangies nga ndjekja penale, zbatimi i masave të sigurimit dhe dënimit për të mitur.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka parashtruar se krahas çështjeve të parashikuara në rezolutën e Kuvendit për veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2023, lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, në vijim do të përcjellë propozime konkrete mbi tematika inspektimi. Gjatë vitit 2024, nuk kanë ardhur tematika të tjera që lidhen me inspektimet.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka përcjellë asnjë tematikë të propozuar.
- Ministri i Drejtësisë:
 - Zvarritje të proceseve gjyqësore dhe mosdorëzim në kohë i vendimeve të arsyetuara në afat së bashku me dosjen gjyqësore, problematikë e cila shtrihet në të gjitha gjykatat e vendit.

Përveç propozimeve të institucioneve, sikundër është vepruar dhe me planet e mëparshme të inspektimit edhe për vitin 2024, gjatë hartimit të planit janë mbajtur në konsideratë:

- Detyrimet ligjore;
- Problematikat e evidentuara nga ankesat e paraqitura;
- Propozimet nga institucionet e përcaktuara me ligj për propozimin e tematikave për inspektimet;
- Kërkesave nga organe të tjera publike;
- Angazhimet dhe detyrimet në kuadër të procesit të integritetit.

Në vitin 2024, ka ardhur kërkesë nga Dhoma Vendore e Avokatisë Sarandë, ku parashtron disa problematika që lidhen me zbatimin e legjislacionit procedural civil dhe penal nga një pjesë e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, dhe veçanërisht, për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në tërësi, arsyetimin e vendimeve gjyqësore, mosrespektimin e listës së avokatëve kryesisht, moskomunikimi në kohë i akteve procedurale të palëve. Kërkesa është marrë në konsideratë dhe propozimi i ardhur do të përfshihet në tematikat e planifikuara për inspektimet e vitit 2025.

❖ Hartimi i Planit të Inspektimeve Tematike

Puna për hartimin e planit i nënshtrohet një diskutimi të gjerë në Mbledhjen e Përgjithshme të inspektorëve, ku merren në shqyrtim të gjithë faktorët e mësipërm dhe pas analizimit të detajuar përzgjidhen ato tematika, të cilat kanë në fokus miradministrimin dhe mbarëvajtjen e sistemit.

Mekanizmi i ngritur nga ILD për marrjen e të dhënave periodike nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive, në kushtet e mungesës së një sistemi elektronik, si dhe aksesit në sistemet aktuale në përdorim nga gjykatat dhe prokuroritë, për të monitoruar aspekte të veprimtarisë së funksionimit të shërbimit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, i shërben efikasitetit dhe kontrollit të sistemit. Raportet e informacionit periodik, shqyrtohen me ekipin e inspektorëve dhe konkluzionet mund të përfshihen në tematika inspektimi ose sipas rastit me verifikime ndaj veprimtarisë së magjistratëve.

Përzgjedhja e tematikave diktohet edhe nga kushtet, kapacitetet e mundësitë objektive në realizimin e planit të inspektimeve. Gjatë diskutimeve, mbahen parasysh dinamikat e inspektimeve të vitit paraardhës si dhe dinamikat e sistemit. Në përfundim të analizës së faktorëve të shpjeguar më sipër, me dakordësinë e Mbledhjes së Përgjithshme të Inspektorëve, është miratuar vendimi nr. 5, datë 31.01.2024 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2024”.

Plani i miratuar përmban tematikat vijuese:

1. “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli elektronik i raporteve të sistemit elektronik për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.05.2024 – 31.12.2024;
2. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.05.2024 – 31.12.2024.
3. “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.05.2024 – 31.12.2024;
4. “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore për periudhën 01.03.2023 – 31.05.2023”, me periudhë realizimi 15.04.2024 – 02.12.2024;
5. “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023”, me periudhë realizimi 01.04.2024 – 30.09.2024;
6. “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.02.2024 – 29.03.2024.

Krahas miratimit të tematikave të inspektimit për vitin 2024, janë përfunduar raportet e inspektimeve vijuese:

1. “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022”.
2. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022”.
3. “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022”.
4. “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”.
5. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”.
6. “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”.

Në krahasim me numrin e inspektimeve të planifikuara për vitin 2023, numri i inspektimeve të miratuar në planin e vitit 2024 është rritur. Plani i vitit 2024 përmban 2 tematika të shtuara, konkretisht inspektimi tematik “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore për periudhën 01.03.2023 – 31.05.2023” dhe inspektimi tematik “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.01.2023-01.06.2023”. Të dyja këto tematika kanë për qëllim adresimin e fenomeneve të evidentuara nga ankesat e përcjella, ankesat e publikut, por edhe si tematika të propozuara me kërkesë të ministrit të Drejtësisë.

Tematikë tjetër e rëndësishme e përfshirë në planin e inspektimeve për vitin 2024, është edhe informimi i palëve nga gjykata për të drejtën e zgjidhjes së çështjeve me ndërmjetësim. Kjo tematikë është përfshirë si një masë në kuadër të procesit të integritetit dhe udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës për këtë qëllim. Nga ana tjetër tematika është vlerësuar me vlerë të veçantë në funksion të rritjes së efikasitetit të sistemit e në respektim të garancive procedurale të individëve, por edhe si një prioritet në kuadër të përshpejtimit të gjykimit të çështjeve dhe uljen e backlog-ut në gjykata.

Përfundimi i inspektimeve ka nxjerrë në pah jo vetëm kontrollin e veprimtarisë së sistemit në aspekt të llogaridhënies së magjistratëve, duke kryer verifikimet për raste ku janë konstatuar shkelje disiplinore, por gjithashtu po krijon premisa për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

3.6.2 Rekomandimet e inspektimeve

Në përfundim të inspektimit në raportet e inspektimit jepen rekomandime, të cilat në varësi të llojit të inspektimit, përmbajnë masa të aspektit:


- i. Rregullator, ku përshihen rekomandime për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Këshillat apo sipas rastit nga kryetarët e gjykatave apo drejtuesit e prokurorive;

- ii. Administrativ, ku përfshihen vlerësime mbi aspekte të efikasitetit të veprimtarisë; organizimit strukturor dhe aspektet të burimeve njerëzore; procedurat e brendshme të punës; shpërndarja e punës; respektimi i etikës; disiplina; marrëdhënia me palët/publikun; financime dhe buxheti; sistemet elektronike, statistikave gjyqësore, siguria e kapacitetit të godinës si dhe çdo çështje e karakterit të përgjithshëm me ndikim në efektivitetin e dhënies së shërbimit; rritje kapacitetesh apo trajnime;
- iii. Disiplinor, ku përfshihen verifikime mbi veprime apo mosveprime të magjistratëve që japin shkak verifikimit apo edhe hetimit disiplinor.

Ndjekja e rekomandimeve sigurohet, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë përmes monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna. Monitorimi realizohet përmes kërkesave drejtuar organeve të inspektuara dhe vlerësimit të informacionit të ardhur nga ekipet e inspektimit.

Në kuadër të monitorimit të inspektimeve të përfunduara, rezulton se për 6 inspektime të përfunduara janë lënë 54 rekomandime, ku 9 rekomandime lidhen me marrjen e masave për miratim/nxjerrje aktesh, 29 rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve administrative dhe 15 rekomandime për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Paraqitja grafike si vijon:



3.6.3 Monitorimi i rekomandimeve

Ndjekja e rekomandimeve sigurohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet mekanizmit monitorues të zbatimit të rekomandimeve të nxjerra. Monitorimi kryhet nëpërmjet marrjes së informacionit nga organet e inspektuara dhe vlerësimit të informacionit të marrë.

Me përfundimin e periudhës së zbatimit (deri në 6 muaj) të përcaktuar në raportin e inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u kërkon organeve të inspektuara informacion mbi zbatimin e rekomandimeve. Të gjitha të dhënat e marra analizohen më tej nga çdo grup inspektimi, për të konstatuar nëse janë marrë masa për adresimin e rekomandimit.

Në aspektin e zbatimit, të gjitha organet e inspektuara kanë ofruar të dhëna ku shprehen për masat apo sfidat përkatëse në arritjen e qëllimit të rekomandimeve. Sfidat janë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, lëvizshmërisë së magjistratëve, infrastrukturës së dobët, mungesës së digjitalizimit ose nevojës për të zhvilluar më tej teknologjinë e informacionit në gjykata dhe prokurori.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve përbën një sfidë edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, pasi çdo inspektim kërkon një nivel të lartë të përfshirjes së burimeve njerëzore, përballë thirrjes për rritjen e numrit të inspektimeve cilësore lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Ndjekja e rekomandimeve është një proces që kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe rritje profesionale si në nivelin e burimeve njerëzore ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve, për të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë, synon t'i përmirësojë në të ardhmen.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë po shqyrton mundësinë e ndjekjes së rekomandimeve jo vetëm në bazë të informacionit të marrë, por edhe nëpërmjet inspektimeve vijuese. Sigurisht, kjo lidhet me sfidat, por aktualisht po vlerësohen mundësitë e testimit të këtij mjeti.

3.7 Analiza e shqyrtimit të ankesave dhe inspektimeve

3.7.1 Mbi shqyrtimin e ankesave

Nëse vërehen shifrat dhe statistikat, gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar 1374 ankesa. Duhet konsideruar që secila prej ankesave, përmban pretendime të ankuesve për një ose më shumë magjistratë. Pra, duke u bazuar në këto shifra, një magjistrat (dhe eventualisht çështjet dhe dosjet e shqyrtuara prej tij), është kontrolluar më shumë se një herë.

Kjo do të thotë se prezenca e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistem është jo vetëm konstante por numri i lartë i shqyrtimit të ankesave, të bën të kuptosh peshën e kontrollit që u përcillet magjistratëve nga verifikimet e bëra, megjithatë mekanizmi i llogaridhënies nuk varet nga numri i rasteve që verifikohen se përbëjnë shkelje disiplinore.

Për vitin 2024, gjatë shqyrtimit të ankesave i është kushtuar vëmendje e shtuar verifikimit të tyre në respektim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka verifikuar çdo ankesë për të cilën nuk ka informacion të qartë. Volumi i punës në çdo fazë të verifikimit,

është i lartë dhe është i njëjtë si në rastet kur ankesa arkivohet, ashtu edhe në rastet kur nga verifikimi rezulton se ekzistojnë dyshime të arsyeshme të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor dhe vlerësimin e peshës së shkeljes disiplinore.

Sfidë për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kuadër të shqyrtimit, verifikimit apo dhe hetimit të ankesave, mbetet mungesa e aksesit në sistemin elektronik të gjykatave dhe prokurorive, për të bërë të mundur marrjen e informacionit të nevojshëm dhe në kohë reale por dhe ngritja e një sistemi të brendshëm efektiv të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve. Mungesa e aksesit jo vetëm kërkon një angazhim më të madh të burimeve njerëzore të cilat vijojnë të kufizohet, por gjithashtu zgjat procesin e shqyrtimit, verifikimit apo hetimit disiplinor.

Shkak për verifikimin me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë bërë edhe dinamikat e proceseve të punës dhe të dhënat që vijnë nga disa burime. Burimi i rëndësishëm për verifikimin, janë të dhënat që kanë dalë nga 4 inspektimet tematike të përfunduara, nga ku janë verifikuar 11 raste individuale (për 3 raste ka filluar hetimi disiplinor, 4 raste janë arkivuar pas verifikimit, pasi nuk janë konstatuar shkelje që justifikojnë hetimin dhe 4 raste janë në proces verifikimi). Burim tjetër janë informacionet e bëra në publik dhe denoncimet e bëra në media, përmendim këtu komunikimin publik të ministrit të Drejtësisë, sipas të cilit pas fillimit të zbatimit të ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, janë shfaqur problematika të diktura nga sjellja e magjistratëve në drejtim të zbardhjes së vendimeve gjyqësore, nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit, apo çështjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë e magjistratëve. Nisur nga ky komunikim publik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 19 vendime verifikimi të cilat janë në proces.

Sërish nga një denoncim i bërë në media, ILD ka reaguar përmes verifikimit të veprimtarisë së një magjistrati, për të cilin filloi hetimin disiplinor me qëllim identifikimin e elementëve juridikë si dhe fakteve apo rrethanave, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor për shkak të ushtrimit të detyrës në kushtet e papajtueshmërisë apo konfliktit të interesit. Në përfundim të hetimit rezultoi e provuar ekzistenca e elementëve faktikë dhe juridikë që provojnë kryerjen e shkeljeve dhe provojnë përgjegjësinë e magjistratit, ndaj të cilit ILD ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor.

Standardet e punës të ndjekura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i referohen vlerave themelore të ushtrimit të pushtetit gjyqësor, sipas të cilit magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë shqyrtimit të ankesave i udhëhequr nga parimi i respektimit të pavarësisë së magjistratit në ushtrimin e detyrës, në mënyrë objektive dhe të balancuar ka marrë masa për të shmangur çdo lloj perceptimi si ndërhyrje në kompetencën

apo zgjidhjen e çështjes konkrete, në respektim të plotë të parimit të përcaktuar në nenin 3 dhe nenin 100 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, parimi i pavarësisë së gjyqtarëve përpos rëndësisë që merr në organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, është i shoqëruar edhe me mekanizmat përkatës, që sigurojnë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e sistemit, kjo me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, mbrojtjen e interesit publik dhe stabilitetin e një shoqërie demokratike. Në këtë këndvështrim Kushtetuta ka parashikuar edhe institucionet dhe mekanizmat përkatës që do të sigurojnë balancën e duhur, ndërmjet respektimit të pavarësisë së gjyqësorit, nga njëra anë dhe parimeve të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga ana tjetër. Secili gjyqtar ka arsyetuar dhe interpretuar dispozitat ligjore në ushtrimin e funksionit të vet kushtetues në zbatim të parimit kushtetues të pavarësisë së gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, ndërsa referuar sërish Kushtetutës kjo pavarësi kornizohet gjithmonë nga parimi i ligjshmërisë dhe ai i përgjegjshmërisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraprakisht analizon faktet (veprimet apo mosveprimet e magjistratit) që pretendohen nga ankuesi, në mënyrë të pavarur në kuadër të procesit të shqyrtimit fillestar, verifikimit apo hetimit disiplinor. Ankuesi mund të pretendojë një tërësi faktesh dhe mund të identifikojë në ankesë çdo lloj shkelje disiplinore që ai pretendon se ka ndodhur, por është Inspektori i Lartë i Drejtësisë i cili në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me procedurën dhe rregullat e parashikuara nga ligji “Për statusin” bën një cilësim të fakteve, veprimeve/mosveprimeve që lidhen me shkeljen disiplinore që pretendohet në ankesë pa u lidhur me përcaktimin që mund të pretendojnë persona fizikë/juridikë.

Në të njëjtën kohë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk ka detyrimin ligjor që të fillojë procedimin disiplinor për çdo pretendim për shkelje disiplinore që paraqitet në ankesë, por të fillojë verifikimin kur ka një dyshim të arsyeshëm se mund të jetë kryer një shkelje disiplinore.

Gjatë vitit 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka arkivuar ankesa edhe për faktin se në të nuk janë përshkruar rrethanat e faktit që pretendohet të kenë ndodhur, nuk ka identifikuar magjistratin për të cilin ka pretendime, apo institucionin në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën në të cilën pretendohet shkelja e kryer.

Ankesat e marra në shqyrtim gjatë këtij viti, janë arkivuar edhe për faktin se magjistrati ka humbur statusin e tij, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar apo dorëheqjes sikurse është përcaktuar në nenet 64 deri 67 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Verifikimi i ankesave është një proces pune voluminoz dhe dinamik, për shkak të shkëmbimit të informacioneve të shumta me gjykatat dhe prokuroritë, procese pune këto të cilat janë ndërprerë si pasojë e humbjes së statusit të magjistratit.

Sa i përket shqyrtimit të ankesave lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesit për veprimtarinë procedurale dhe ligjore të magjistratit, qëndrimi i mbajtur për këtë veprimtari është se çdo pretendim ndaj magjistratëve gjyqtarë se kanë dhënë vendime të padrejta, janë prishur apo ndryshuar nga gjykata më të larta, në thelb janë pretendime që lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore, si dhe vlerësimin e provave nga gjykatat respektive, si një atribut i pushtetit gjyqësor dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të ndërhyjë apo të marrë atributet e këtij pushteti.

ILD, ka verifikuar edhe 6 ankesa për magjistratë të cilët janë në kushtet e mbrojtjes së posaçme nga hetimi disiplinor sipas nenit 149, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këto kushte, ILD ka përfunduar verifikimin e ankesës pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur verifikimi është bërë i pamundur.

3.7.2. Mbi ankimet ndaj vendimeve të arkivimeve dhe mbylljes së hetimeve

Nga 762 vendime objekt ankimi, janë ankimuar vetëm 89 vendime arkivimi, 68 ankime pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 21 vendime pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose shprehur në përqindje, janë ankimuar 11.6% e vendimeve të arkivimit. Nga të gjitha ankimet e paraqitura nuk rezultojnë vendime të kthyera për shqyrtim. Ndërsa për 3 vendime për mbyllje të hetimit disiplinor të nisur mbi bazë ankese rezulton se nuk ka asnjë ankim në Komisionet e Përkohshme të Shqyrtimit të Ankimeve. Nga të gjitha ankimet e shqyrtuara nuk rezultojnë vendime të kthyera për shqyrtim.

Sikurse evidentohet më sipër, për vitin 2024 rezulton të ketë sërish një numër të ulët të ankimeve, në Komisionet e Përkohshme pranë Këshillave, ndaj vendimeve të ILD-së. Për të gjitha ankimet kundër vendimeve të arkivimit, rezulton se për të gjitha rastet, Komisionet kanë vendosur refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është cenuar.

Mjeti i ankimit në dispozicion të ankuesit dhe shqyrtimi i tyre nga komisionet përkatëse të parashikuara në ligj japin sigurinë dhe garantojnë se vendimmartja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është objekt shqyrtimi i ligjshmërisë në mënyrë të vazhdueshme. Nga rezultatet e ankimeve të vitit 2024, por edhe atyre të mëparshme, rezulton se praktika e punës dhe standardet e ndjekura deri tani, nuk janë cenuar nga organet kompetente të përcaktuara me ligj për shqyrtimin e tyre.

3.7.3 Mbi hetimin disiplinor

Krahasimisht me një vit më parë, ka një rritje të numrit të hetimeve të kryera, por edhe i llojit të shkeljeve disiplinore të hetuara, sikundër është edhe etika, papajtueshmëria dhe konflikti i interesit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer dy hetime, objekti i të cilave ka qenë papajtueshmëria dhe konflikti i interesit të cilat janë bërë shkak edhe për kontrollin e pasurisë të këtyre dy subjekteve pranë organeve kompetente për pasurinë, tatimet, regjistrat e pasurive, regjistrat e lejeve dhe licencave dhe organeve të tjera, veprimtaria e së cilave lidhet me faktet dhe objektin e hetimit. Standarde të cilat përkojnë me praktikën dhe standardet e procesit të rivlerësimit kalimtar (vetting).

Hetimi disiplinor si mjeti për të siguruar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e magjistratëve është realizuar sipas standardeve të procedimit disiplinor në respektim të plotë të kriterëve ligjore dhe atyre institucionale. Për çdo hetim të ndërmarrë janë ndjekur parimet e sanksionuara në ligj si nga pikëpamja e fakteve, provave, ligjit ashtu edhe nga pikëpamja e zbatimit të të drejtave kushtetuese dhe elementëve të procesit të rregullt ligjor.

Rritja e numrit të hetimeve, ka shënuar edhe rritje të standardeve të brendshme të punës për të verifikuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme të gjitha pretendimet, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve, vlerësim të hollësishëm të provave dhe veprimeve/sjelljeve të magjistratit, që provojnë ekzistencën e kryerjes së shkeljes nga magjistratëve.

Hetimet disiplinore të realizuara kanë pasur si qëllim zhvillimin e proceseve në përputhje me parimin e proporcionalitetit, objektivitetit dhe individualizimit të përgjegjësisë disiplinore.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë për çdo rast të hetuar, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit, ka vlerësuar dëshmitë dhe ka qartësuar rrethanat që kanë diktuar nisjen e hetimit, duke faktuar dhe provuar ekzistencën e elementëve juridikë dhe faktikë që provojnë ekzistencën e kryerjes së shkeljes disiplinore nga magjistratët.

Në përfundim të hetimit Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ose ka mbyllur hetimin, për shkak të provave të pamjaftueshme për të provuar shkeljen ndaj magjistratit. Për vendimet e mbylljes së hetimit disiplinor nuk ka asnjë ankim të paraqitur në Këshilla.

3.7.4 Mbi kërkesat për procedim disiplinor

Për vitin 2024, ka një dyfishim të kërkesave për procedim disiplinor, krahasuar me një vit më parë, konkretisht për këtë vit janë 11 magjistrat të proceduar, për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit, por dhe për shkelje të etikës.

Në kuadër të procedimit disiplinor Këshillat e kanë vlerësuar hetimin e kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të plotë, pasi nuk kanë vendosur në ndonjë rast kthim të hetimit apo zhvillim të mëtejshëm të hetimit me veprime konkrete hetimore, duke mos u cenuar kështu ligjshmëria e hetimit dhe verifikimit të shkeljes.

Vendimmarrja e Këshillave për shqyrtimin e kërkesave për procedim disiplinor është në diskrecionin institucional në përputhje me parimin e pavarësisë dhe ndarjes së pushteteve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përputhje me jurisprudencën gjyqësore që trajton vendimmarrjet e Këshillave në rastet e procedimeve disiplinore vlerëson se gjatë zhvillimit të procedimeve disiplinore, Këshillat kanë respektuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligj dhe rregulloret respektive të tyre sa i takon zhvillimit të seancave, të administrimit të provave, aksesit të palëve në informacion dhe respektimit të afateve të procedimit disiplinor.

3.7.5 Mbi inspektimet

Inspektori i Lartë i Drejtësisë përmes mekanizmave të inspektimeve tematike, është aktiv në sistemin e kontrollit të punës së magjistratëve, duke përcaktuar standarde të një sistemi funksional llogaridhënës, në përputhje me balancën që duhet të ekzistojë edhe me parimin e ndarjes së pushteteve, duke përcaktuar standarde për një sistem drejtësie të përgjegjshëm, të paanshëm dhe me integritet.

Përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve të punës dhe testimi i mjeteve të reja për marrjen e informacioneve në funksion të adresimit të tematikave të inspektimit kanë shërbyer në rritjen e numrit të inspektimeve, por edhe të adresimit të çështjeve që sot janë shqetësimi i publikut. Ndër masat e marra në funksion të adresimit të problematikave që janë paraqitur në planin e inspektimeve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

- Ka ngritur mekanizmin administrativ të monitorimit të veprimtarisë së magjistratëve përmes marrjes së informacionit periodik nga gjykatat dhe prokuroritë, duke evidentuar kështu ato fenomene të cilat janë përfshirë në tematika inspektimi që lidhen me cilësinë dhe efikasitetin e sistemit.
- Pjesëmarrja në analizën vjetore të gjykatave duke u njohur nga afër me sfidat e sistemit gjatë vitit.
- Pjesëmarrja në takime pune me këshillat për të diskutuar dhe forcuar bashkëpunimin përmes propozimeve me tematika.

Nga veprimtaria e inspektimeve tematike dhe institucionale Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka siguruar jo vetëm përgjegjësinë e magjistratëve duke hetuar shkeljet e dyshuara, por edhe adreson sistemin gjyqësor me rekomandime për masa të karakterit rregullator, të karakterit

administrativ dhe institucional për t'u ndjekur nga subjektet e inspektimit, si dhe organet e tjera që kanë funksione qeverisëse ndaj sistemit.

ILD, përveç rekomandimeve të lëna për subjektet e inspektimit ka dhënë rekomandime edhe për organe të tjera, veprimtaria e të cilave ndikon në performancën e sistemit gjyqësor, siç janë masat për:

- Propozim për ndryshime të akteve apo nxjerrjen e tyre;
- Ndryshim të praktikës administrative të ndjekur duke propozuar masa për veprime administrative;
- Fuqizim të kapaciteteve të burimeve njerëzore duke propozuar ndjekjen e tematikave të caktuara në formimin vazhdueshëm të magjistratëve.

Disa metoda në aspektin administrativ mund të zbatohen nga vetë gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve. Një tjetër mekanizëm për rritjen e efikasitetit mund të jetë edhe sistemi i vlerësimit të magjistratëve, i cili mund t'i nxisë në mënyrë të vazhdueshme të rrisin performancën, apo rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare. Megjithatë, vlen të theksohet se për rastet e mësipërme mjeti i fundit dhe i jashtëzakonshëm i cili duhet të aplikohet është procedimi.

Inspektimet tematike kanë nxjerrë në pah edhe veprime apo mosveprime të magjistratëve, ndaj të cilëve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar verifikimin, rezultatet e të cilit kanë çuar në përgjegjësi disiplinore për disa magjistratë dhe vijon puna për verifikimin e rasteve të tjera.

Si konkluzion, nga të dhënat e mësipërme rezulton se mekanizmi i kontrollit të llogaridhënies ndaj sistemit të drejtësisë është duke funksionuar, me standarde të ngritura dhe të konfirmuara, pa përjashtuar këtu edhe nevojën për fuqizim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Në këtë drejtim janë duke e fuqizuar mekanizmat e monitorimit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si një mjet që do të kontribuojë në vijimësi të kontrollit të punës duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e sistemit, ndaj individit dhe shtetit të së drejtës.

IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR^[9]

Bashkëpunimi dhe forcimi i marrëdhënieve institucionale me organet e sistemit të drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtarë për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë vijon të jetë një aspekt esencial për koordinimin e aktiviteteve, në funksion të arritjes së qëllimeve të përbashkëta për konsolidimin e veprimtarisë së organeve të sistemit të drejtësisë dhe forcimin e besimit të publikut për veprimtarinë e ILD-së. Nga ana tjetër ky bashkëpunim i shërben edhe forcimit të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të stafit të ILD-së.

4.1 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - KLGJ/KLP/KPK

Sa i takon bashkëpunimit me këshillat, përtej rekomandimeve të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023”^[10], Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me prioritet dhënien e informacionit lidhur me ankimet e depozituara në këshilla, sa i takon vendimmarrjeve të ILD-së për arkivimet dhe mbylljen e hetimeve, informacion mbi të dhënat e ankesave të depozituara për magjistratët që janë në proces vlerësimi dhe për ata që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Për vitin 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë si në shkëmbim informacioni, ashtu edhe në diskutime për çështje profesionale me interes reciprok, si më poshtë:

- Këmbimit të të dhënave të përditësuara për magjistratët, të cilët ushtrojnë aktualisht detyrën, janë pjesë e skemës së delegimit apo transferimit, si dhe të dhënat lidhur me listën e ish-magjistratëve, të cilët nuk janë më pjesë e sistemit të drejtësisë.
- Shkëmbimit të informacioneve në kuadër të procesit të shqyrtimit të ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit ose vendimeve të mbylljes së hetimit disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (68 raste) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (21 raste).
- Shkëmbimit të informacioneve në kuadër të procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve, me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për 64 raste dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për 54 raste.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë referime në këshilla për vlerësimin etiko-profesional, në rastet kur është mbyllur hetimi disiplinor për magjistratë të caktuar, për shkak se nga faktet e vlerësuara nuk justifikohet fillimi i procedimit disiplinor, apo

⁹ Për çdo aktivitet të përmendur ka një publikim të posaçëm në faqen zyrtare të ILD-së, në shqip dhe anglisht

¹⁰ Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2024/07/31/rezolute-e-kuvendit-per-vleresimin-e-veprimtarise-se-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë-per-vitin-2023/>

edhe në rastet kur pas verifikimit të pretendimeve, nuk ka pasur fakte mjaftueshëm për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor. Gjatë vitit 2024, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë referuar 5 raste dhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë referuar 3 raste.

- Në ditën e drejtësisë, përfaqësues të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë në mbledhjen e përbashkët plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku u paraqit dhe u diskutua draft-rregullorja “Për bashkimin e procedimeve disiplinore për rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje”. Procesi i draftimit të kësaj rregulloreje ka kaluar në faza të gjata konsultimesh dhe diskutimesh, ndërmjet anëtarëve të grupit të punës, që përbëhej nga Komisionet Disiplinore të secilit prej këshillave dhe përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nën asistencën e ekspertëve të misionit EU4JUSTICE.
- Gjatë muajit qershor 2024, përfaqësues të ILD-së, KLGJ-së dhe KLP-së, kanë marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët pune, në funksion të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë, me fokus të veçantë në vlerësimin e vazhdueshëm të gjyqtarit dhe prokurorit.
- Në dhjetor 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një takim pune në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me anëtarë të KLP-së, këshilltarë ligjorë dhe përfaqësues të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit. Në qendër të bashkëbisedimit ishte trajtimi i sfidave që lidhen me komunikimin institucional dhe forcimi i mëtejshëm i sinergjisë së bashkëpunimit mes dy institucioneve për një sistem drejtësie efikas e më të qëndrueshëm.

Komunikimi me këshillat është i vazhdueshëm për bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e informacionit në kohë dhe në cilësi.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për vendimmarrje ndaj magjistratëve prokurorë apo gjyqtarë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka shkëmbyer informacion në kuadër të kërkesave të KPK-së, në funksion të procesit të rivlerësimit. Ky komunikim ka vijuar sistematik, për shkak të nevojave reciproke për informacion të përditësuar, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në trajtimin e ankesave ndaj magjistratëve që janë në detyrë. Për çdo komunikim, që lidhet me referimet e KPK-së për verifikim ndaj veprimtarisë së magjistratëve, edhe pse të konfirmuar në detyrë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar rastet duke kryer verifikimet e nevojshme.

Gjatë vitit 2024, bashkëpunimi me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ka vijuar me shkëmbimin e informacionit në kuadër të procesit të rivlerësimit të magjistratëve gjithsej për 6 raste.

4.2 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Prokurorin e Përgjithshëm

Bashkëpunimi me Prokurorin e Përgjithshëm ka vijuar edhe gjatë vitit 2024 në kuadër të angazhimeve të ndërsjella, në funksion të sugjerimit të tematikave të inspektimit, në kuadër të informacionit, që ka të bëjë me shkelje individuale të prokurorëve, por edhe në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në shkurt të vitit 2021 mes dy institucioneve.

4.3 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrin e Drejtësisë

Bashkëpunimi me Ministrin e Drejtësisë ka vijuar dhe është rritur gjatë vitit 2024, në disa drejtime. *Së pari* është rritur bashkëpunimi në funksion të tematikave të inspektimit, për çështje që adresojnë aspekte të rritjes së cilësisë së sistemit dhe që kanë pikëprerje të përbashkët me problematikat, që shfaqen edhe përmes procesit të shqyrtimit të ankesave në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Dimensioni tjetër i bashkëpunimit është rritur në drejtim të referimit të ankimeve konkrete institucionale, për sjellje të magjistratëve, për problematika në kuadër të sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Nisur nga avancimi i shpejtë i Shqipërisë, sidomos këto dy vitet e fundit, me procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por edhe nga përparimi i hapjes së negociatave për grupkapitullin e parë themelor, sa i takon Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, edhe për vitin 2024, bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka pasur si kryefjalë integrimin evropian. Bashkëpunimi ka konsistuar në raporte, pjesëmarrje në takime me përfaqësues të Komisionit Evropian, takime koordinuese me titullarë të institucioneve të pavarura, takime të përfaqësuesve në Grupin Ndërinstitucional të punës për Integrimin Evropian.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka qenë pjesë aktive në tryezat e hartimit dhe të bashkërendimit të dokumenteve strategjike dhe konkretisht në Hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030, si dhe në hartimin e raporteve të ndryshme në zbatim të këtyre dokumenteve.

4.4 Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile

Në funksion të transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka krijuar një traditë të bashkëbisedimeve me grupe të ndryshme shoqërore, duke mbajtur komunikime edhe jashtë institucionit përmes edukimit ligjor. Nga ana tjetër as gjatë vitit 2024 nuk ka munguar vëmendja për Organizatat e Shoqërisë Civile, që kanë në fokus drejtësinë e të drejtat e njeriut si për komunikime ashtu edhe për aktivitete. Gjatë vitit janë kryer aktivitetet si më poshtë vijon:

- Në fillim të muajit janar 2024 është zhvilluar një leksion i hapur me pjesëmarrësit e Akademisë së Integritit Evropian dhe Negociatave, në modulën “Pavarësia dhe efikasiteti i Sistemit të Drejtësisë, reformat para dhe pas anëtarësimit”, në kuadër të edicionit “Shteti i së Drejtës”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë bëri një prezantim të rolit dhe funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe iu përgjigj pyetjeve mbi institucionin që drejton, sistemin e ri të drejtësisë dhe pritshmëritë e publikut.
- Nga angazhimet me organizata të Shoqërisë Civile, në muajin qershor 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mori pjesë në “IDM Morning Briefing”, një forum komunikimi, i organizuar nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim, që synon nxitjen e një diskutimi të hapur me titullarë institucionesh, deputetë të Kuvendit, përfaqësues të shoqërisë civile, të medias, akademikë e shkollare etj., mbi çështje të interesit publik e institucional. Në cilësinë e të ftuarit të nderit, bashkëbisedimi i të pranishmëve me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, i shërbeu nxitjes së një diskutimi bazuar në evidenca, mbi cilësinë e Drejtësisë në përgjithësi, e me përfundimin e procesit të vettingut, sfidat e ILD, si institucioni përgjegjës për shkeljet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, menaxhimin e ankesave, nismën parlamentare për thellimin e reformave, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin, çështje të pavarësisë e ndarjes së pushteteve, si dhe perspektivat për të ardhmen në kontekstin aktual të reformës në drejtësi në Shqipëri.
- Një tjetër takim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ishte ai që u zhvillua në korrik 2024 me Akademinë Diplomatike të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku z. Metani referoi mbi “Rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kuadër të reformës në drejtësi, sfidat e ecurisë së saj dhe diplomacia në raport me të”, përpara ambasadorëve të Shqipërisë të akredituar në vende të ndryshme dhe diplomatëve të tjerë, online dhe fizikisht në ambientet e MEPJ. Gjatë fjalës së tij, z. Metani gjeti dakordësinë e diplomatëve shqiptarë, mbi rëndësinë që duhet të marrë edhe komunikimi diplomatik për drejtësinë në Shqipëri, veçanërisht në fazën ku ndodhen negociatat e Shqipërisë me BE-në, si dhe vëmendjen që ka Unioni për shtetin e së drejtës e sundimin e ligjit, që u konkretizua me përfshirjen për herë të parë, të Shqipërisë e vendeve të tjera aspirante të rajonit, në Raportin Vjetor të Komisionit Evropian mbi sundimin e ligjit.
- Në kuadër të monitorimeve që i bëhen sistemit të drejtësisë nga Organizatat e Shoqërisë Civile, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në aktivitetin e organizuar në nëntor 2024 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, mbi një raport monitorimi mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë vitit 2023. Inspektori i Lartë i Drejtësisë e vlerëson si tejet të rëndësishëm rolin e organizatave të shoqërisë civile, në monitorimin e punës së institucioneve të drejtësisë dhe Komiteti i Helsinkit është një nga gjashtë organizatat, me të cilat ILD ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mars të vitit 2022, me synim rritjen e performancës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes rritjes së komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta, në kuadër të

monitorimit, analizimit, procesit llogaridhënës dhe ndërgjegjësues mbi veprimtarinë e Zyrës së ILD-së, përmes shkëmbimit të të dhënave, organizimit të takimeve periodike, ofrimit të ekspertizës përkatëse të OSHC-ve të specializuara.

- Në mbyllje të vitit kalendarik dhjetor 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një takim pune me drejtues të organizatave të shoqërisë civile, që kanë pjesë të punës së tyre monitorimin e reformës në drejtësi, e të drejtave të njeriut, transparencën, llogaridhënien e mirëqeverisjes. Takimi u zhvillua me Institutin e Studimeve Politike, Institutin për Studime Publike e Ligjore, Qendra për Zhvillim dhe Integrim Evropian, Qendra për Çështje të Informimit Publik (INFOÇIP) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Në takim u bashkëbisedua mbi aspekte të punës së ILD-së dhe çështje të sistemit të drejtësisë, duke përcjellë këndvështrime, por edhe propozime për efikasitetin e punës së ILD-së gjatë vitit të ardhshëm.

4.5 Marrëveshje bashkëpunimi dhe aktivitete nga marrëveshjet

- Në prill 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një vizitë pune në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, ku nënshkroi një memorandum bashkëpunimi, në kuadër të bashkëpunimit të institucionit me fakultetet e drejtësisë të Universiteteve Publike të vendit. Më pas z. Metani zhvilloi një leksion të hapur me studentë të Fakultetit të Drejtësisë mbi rolin e ILD-së në arkitekturën e re të sistemit të Drejtësisë, duke iu përgjigjur interesit të auditorit mbi aspekte të punës, të hetimit e procedimit disiplinor, mbi etikën e magjistratëve, por edhe mënyrën sesi të rinjtë e shohin sistemin e drejtësisë dhe funksionimin e tij.
- Në maj 2024 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës kanë zyrtarizuar bashkëpunimin, përmes një marrëveshjeje, që u nënshkrua nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës z. Arben Rakipi. Memorandumi parashikon bashkëpunimin e ngushtë për çështje me interes të përbashkët, në drejtim të forcimit të bashkëpunimit për përfshirjen në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të moduleve dhe temave të trajnimit, të përshtatshme në interes të inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit çdo vit.
- Në dhjetor 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë mikpriti një grup studentesh e pedagogesh të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Vizita studimore 4 ditore e delegacionit nga Kosova është pjesë e bashkëpunimit që Zyra e ILD-së ka vendosur me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, përmes marrëveshjes së nënshkruar në tetor 2022 në kryeqytetin e Kosovës.

4.6 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë

- Bashkëpunimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë bëhet në tre dimensione: forcimin e kapaciteteve, përmes trajnimit të vazhdueshëm të njësive dhe sektorëve të ndryshëm të stafit të institucionit, takime pune në funksion të fushës së përbashkët dhe komunikim për arritje e sfida të institucionit dhe drejtësisë në vend. Aktivitetet zhvillohen si pjesë e bashkëpunimit me partnerët që asistojnë ILD-në në Shqipëri, por edhe në kuadër të eventeve e projekteve, si anëtar i Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë.
- Në këtë kuadër gjatë vitit 2024 janë realizuar disa aktivitete të rëndësishme, të cilat renditen si vijon:
- Në shkurt 2024, Njësia e Inspektorëve dhe ajo e ndihmës Inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë në trajnimin e targetuar mbi identifikimin dhe adresimin e çështjeve të konfliktit të interesit në kuadrin e hetimit disiplinor, organizuar nga misioni i ekspertëve të Projektit EU4Justice, që asiston ILD-në. Identifikimi, adresimi dhe trajtimi i çështjeve të konfliktit të interesit, në kuadrin e hetimit disiplinor mbetet i rëndësishëm për vetë rolin që ka ky proces, që është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet hetimit të shkeljeve disiplinore të magjistratëve.
- Në prill 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në institucionet e drejtësisë në Hagë të Mbretërisë së Holandës. Synimi i vizitës ishte njohja dhe shkëmbimi profesional me drejtues e përfaqësues të sistemit të drejtësisë së Holandës me praktikant më të mira të shtetit të së drejtës dhe sfidat që ka sistemi i drejtësisë, jo vetëm në vende me demokraci të re si Shqipëria, por edhe ato me demokraci të konsoliduar si Mbretëria e Holandës. Në Gjykatën e Lartë të Holandës, z. Metani zhvilloi një takim me anëtarin e kësaj gjykate, gjyqtarin Marc Fierstra, pjesë e trupës së posaçme të Gjykatës së Lartë që trajton masat disiplinore ndaj magjistratëve dhe njëkohësisht Kryetar i Shoqatës Holandeze për gjyqësorin. Më tej z. Metani takoi Prokurorin e Përgjithshëm të Gjykatës së Lartë të Holandës, z. F. W., (Edwin) Bleichrodt, si institucioni që trajton mes të tjerash, edhe shkeljet e gjyqtarëve, Presidentin e Agjencisë Evropiane për bashkëpunim në drejtësinë penale (EUROJUST) z. Ladislav Hamran dhe departamentin e Integritimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar një takim zyrtar në Tiranë gjatë vitit 2024 edhe me prokurorin e përgjithshëm të Mbretërisë së Spanjës z. Álvaro García Ortiz. Inspektori i Lartë i Drejtësisë e njohu z. Álvaro García Ortiz me eksperiencën e ILD-së me homologët e Shërbimit të Inspektimit të Drejtësisë të Spanjës në kuadër të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), marrëdhënie dypalëshe e formalizuar me një marrëveshje bashkëpunimi një vit më parë e së fundi me ekspertët spanjollë të projektit të BE-së, EU4Justice, që mbështesin ILD-në, në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale. Duke diskutuar për filozofinë e punës

së ILD-së, për gjetjen e balancës mes interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm i Mbretërisë së Spanjës bashkë ndanë mendimin, se pavarësia e magjistratëve mbetet baza ku mbështeten themelet e shtetit të së drejtës dhe element kyç për funksionimin e çdo demokracie, me rëndësi të veçantë për rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

- Në prill 2024 inspektorë dhe ndihmës inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në dy ekipe zhvilluan dy vizita njëjavore pune në Mbretërinë e Spanjës. Vizitat studimore ishin pjesë e mbështetjes së projektit EU4Justice, që synon rritjen e kapaciteteve dhe përfitim të eksperiencave nga institucionet homologe evropiane. Gjatë këtyre vizitave, inspektorët dhe ndihmës inspektorët e ILD-së patën takime në institucione të ndryshme të drejtësisë. Ekipet e ILD-së patën rastin të jenë pjesë e inspektimeve të gjykatave të juridiksionit të Valencia-s dhe Murcia-s, nëpërmjet inspektimit telematik (online), si dhe atij në terren, duke shqyrtuar hap pas hapi fazat e ndryshme të inspektimit tematik, si dhe intervistat e strukturuar me personel gjyqësor dhe administrativ të gjykatave përkatëse. Përveç marrjes së eksperiencës profesionale, vizitat e punës shërbyen edhe për forcimin e bashkëpunimit me Shërbimin Spanjoll të Inspektimit, me të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mars 2023.
- Në maj 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një vizitë pune në SHBA, me titullarë të drejtësisë në Departamentin e Drejtësisë së SHBA, të mundësuar nga Zyra për Zhvillimin, Ndihmën dhe Trajnimin e Prokurorisë Jashtë Vendit (OPDAT) në Ambasadën e SHBA në Tiranë. Gjatë vizitës së tij në Uashington DC, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u takua me Inspektorin e Përgjithshëm të Departamentit të Drejtësisë, Zëvendës Ndihmës Prokurorin e Përgjithshëm dhe Këshilltarin e Zyrës së Përgjegjësisë Profesionale. Zyrtarët amerikanë riafirmuan mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në misionin e saj jetik në mbështetje të profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit mes gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në vijim të vizitës së punës në SHBA, në kuadër të Ditës kombëtare të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një bashkëbisedim me juristë dhe profesionistë shqiptarë në Nju Jork, një takim i organizuar nga “Rrjeti i Profesionistëve dhe Sipërmarrësve Shqiptarë” (The Albanian Professionals and Entrepreneurs Network-APEN). Bashkëbisedimi u drejtua nga gjyqtarja e parë shqiptare e zgjedhur në Nju Jork, znj. Edit Shkreli e Gjykatës Civile të Bronksit, me të cilën z. Metani u ndal tek ndryshimet e realizuara në Shqipëri në kuadër të reformës në drejtësi me institucione të reja, një prej të cilave është edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pas prezantimit të rolit dhe funksioneve të institucionit që drejton, z. Metani iu përgjigj interesimit mbi aspekte të ndryshme të shtetit të së drejtës dhe institucioneve në Shqipëri.
- Në maj 2024 një mision afatshkurtër ekspertësh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i Spanjës zhvilluan sesione trajnuese me punonjës të Zyrës së ILD-së, me synim

kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse të situatës aktuale teknologjike të institucionit. Aktiviteti synonte vlerësimin e situatës aktuale dhe sugjerimin e masave për të përmirësuar efikasitetin dhe transparencën e ILD-së, duke konsideruar domosdoshmërinë e krijimit dhe përdorimit të një sistemi plotësisht elektronik të përpunimit të ankesave. Anëtarë të kabinetit, punonjës të njësisë së ndihmës inspektorëve, drejtorisë së hartimit të akteve dhe shërbimeve juridike, të sektorit të metodikës e standardeve, sektorit të teknologjisë së informacionit dhe sektorit të arkiv-protokollit, u njohën nga ekspertët spanjollë të teknologjisë së informacionit e dokumentacionit me kontekstin e gjyqësorit spanjoll, praktikat më të mira, instrumente dhe modelin e motorit të kërkimit të vendimeve në praktikat gjyqësore. Aktiviteti është pjesë e mbështetjes së projektit EU4Justice për forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Në cilësinë e anëtarit të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), në maj 2024 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ishte pjesë aktive e konferencës përmbyllëse të projektit COPEIJ që u mbajt në Hagë, “Bashkëpunimi në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë”, që bëri bashkë përfaqësues të Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë, Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë të Italisë, Këshillit të Lartë të Gjyqësorit të Portugalisë, Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë, anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ). I nisur dy vite më parë, me financim të Komisionit Evropian, projekti COPEIJ analizoi dhe promovoi efektivitetin e mbrojtjes së mjedisit nga drejtësia penale në BE, duke përfshirë shërbimet kombëtare të inspektimit, në kuadër të direktivës së re të Bashkimit Evropian të 11 prillit 2024 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, që i detyron vendet anëtare të adoptojnë brenda dy viteve, rregulla kombëtare në përputhje me parashikimet e kësaj direktive. Gjatë eventit përmbyllës, që u mbajt në mjediset e Eurojust në Hagë, u paraqitën dhe diskutuan sfidat e luftës kundër krimit mjedisor në Evropë, veçanërisht në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, zhvillimet e fundit në këtë fushë dhe u vlerësuan praktikat dhe risitë e mira të identifikuara nga ekipi COPEIJ për të përmirësuar efektivitetin e tij. Funkionarë dhe ekspertë nga Komisioni Evropian, Eurojust, Europol, magjistratë, drejtues të organeve ligjzbatuese që merren me krimin mjedisor, avokatë dhe pedagogë nga vende të BE, diskutuan për dy ditë mbi luftën ndaj krimit mjedisor në Evropë, fenomenet dhe prioritetet kombëtare, sfidat në luftën kundër krimit mjedisor: organizimi gjyqësor për një drejtësi efikase përmes harmonizimit të standardeve dhe praktikave gjyqësore, mekanizmat për të përmirësuar luftën kundër krimit mjedisor.
- Në muajin qershor 2024, një ekip i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i përbërë nga inspektorë, ndihmës inspektorë dhe anëtarë të kabinetit zhvilloi një vizitë studimore 5 ditore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, në Paris, me mbështetjen e Expertise France dhe EU4Justice. Shefi i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë, z. Christophe Straudo, bëri një paraqitje të funksioneve të ndryshme të Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë dhe dimensionet e punës

inspektuese. Ndërsa në ditët në vijim, departamente të Inspektoratit francez dhe institucione të lidhura me të, zhvilluan sesione pune me ekipin e ILD-së, mbi procedurën para-disiplinore të magjistratëve, hetimet administrative, metodologjinë, të drejtat e mbrojtjes, teknikat e objektivizimit, çështje të etikës së magjistratëve, që u pasuan me diskutime profesionale me ekipin e ILD-së.

- Paralelisht me këtë vizitë studimore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi takime pune të organizuara nga homologu francez z. Christophe Straudo. Të dy vlerësuan praktikën e shkëmbimit të eksperiencave ndër vite mes dy shërbimeve të inspektimit të Francës dhe Shqipërisë, si dhe bashkëpunimin, si pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ). Z. Metani pati një takim pune me prokurorin e përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë, z. Remy Heitz, njëkohësisht Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor për prokurorët, me gjyqtaren Valérie Delnaud, që drejton kabinetin e ministrit të Drejtësisë, me drejtoren e shkollës franceze të magjistraturës znj. Nathalie Roret etj.
- Në shtator 2024, z. Metani u angazhua në takimin e dytë të Komitetit Drejtues të Përfituesve të programit “Instrumenti horizontal III për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Z. Metani veçoi bashkëpunimin ndër vite të Zyrës së ILD-së me këtë iniciativë të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në kuadër të forcimit të cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri.
- Gjatë muajit tetor 2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një vizitë pune në Stokholm (Mbretëria e Suedisë), me mbështetjen e ambasadës së Shqipërisë në Suedi. Gjatë takimeve në Parlament, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Jashtme të Suedisë, u prezantua funksioni dhe roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe kontributi në forcimin e shtetit të së drejtës, si një element kyç për procesin e negociimit të Shqipërisë për anëtarësim me Bashkimin Evropian.
- Interesimi mbi ecurinë e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe punës së institucioneve për konsolidimin e demokracisë ishte në qendër të takimit që z. Metani zhvilloi në komisionin për çështje të BE në parlament, e më tej me dy deputetë me origjinë nga Kosova, znj. Aida Birinxhiku dhe z. Arbër Gashi. Në Ministrinë e Jashtme u diskutua mbi ecurinë e zbatimit të reformës në drejtësi në Shqipëri, me vëmendje rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistem. Çështje të standardeve të punës së magjistratëve, besimit publik tek sistemi i drejtësisë dhe shkëmbimi i eksperiencave, u diskutuan në takimin që delegacioni pati në ministrinë e drejtësisë, me drejtoren e përgjithshme të marrëdhënieve me jashtë Dr. Anna-Carin Svensson.
- Po në tetor 2024, në funksion të vëmendjes së shtuar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për detyrimet që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, një takim konsultativ pune u zhvillua mbi dokumentin “Pozicioni i përbashkët i Bashkimit Evropian”, pak ditë pas publikimit të tij, në kuadër të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë për grupkapitullin e parë themelor. Njësia e inspektorëve, ajo e ndihmës inspektorëve dhe anëtarë të kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë diskutua mbi gjetjet e raportit për aspekte

të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe marrjen e masave të nevojshme në funksion të adresimit të gjetjeve. Diskutimet u shtrinë në aspekte të proceseve të përditshme të punës, që nga administrimi i një ankese që mund të bëhet ndaj një gjyqtari a prokurori, e deri tek hetimi e procedimi disiplinor ndaj dhe u ndanë këndvështrime për përmirësimin e ritmit të punës, bazuar në kapacitetet ekzistuese.

- Në tetor 2024, Njësia e inspektorëve dhe ajo e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan fazën e dytë të trajnimit mbi rritjen e efikasitetit të ILD-së në drejtim të inspektimeve tematike dhe institucionale, mbështetur nga projekti EU4Justice. Trajnimi 3 ditor që u mbajt në Tiranë kishte në fokus përgatitjen, kryerjen dhe analizimin e inspektimit institucional pranë gjykatave dhe prokurorive dhe u zhvillua si ndërthurje e kuptimit teorik me zhvillimin e aftësive në praktikë, për të krijuar një mjedis të favorshëm dhe bashkëpunues në konceptimin dhe kryerjen e inspektimit institucional, nga eksperti magjistrat francez, z. Vincent Delbos dhe ekspertja magjistrate rumune znj. Nicoleta Rhfir. Pjesë e këtij trajnimi ishin edhe çështjet etike për inspektimet institucionale e më tej, hetimet disiplinore.
- Në dhjetor 2024, njësia e inspektorëve bashkë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë zhvilluan një vizitë pune pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg (Francë). Delegacioni shqiptar zhvilloi sesione profesionale pune me gjyqtarë dhe juristë të GJEDNJ-së, mbi procesin disiplinor dhe lidhjen e tij me pavarësinë e magjistratëve si dhe paraqitje e diskutime të neneve 8, 10 dhe nenit 6, pjesa civile, mbi standardet e punës në kontekstin e procedimeve disiplinore. Në kuadër të kësaj vizite, ambasada e Shqipërisë në Strasburg organizoi një pritje me ambasadorë të vendeve të Këshillit të Evropës, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, në cilësinë e të ftuarit të nderit bëri një panoramë të reformës në drejtësi në Shqipëri, sfidave dhe rolit të ILD-së dhe iu përgjigj interesit të ambasadorëve të pranishëm mbi aspekte të punës së sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

4.7 Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, në kuadër të procesit për integrimin evropian.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është pjesë e rrjetit të institucioneve kyçe në kuadër të angazhimeve dhe masave në kuadër të disa raporteve ndërkombëtare, në kuadër të procesit të integritetit. Nën drejtimin dhe koordinimin e raporteve, informacioneve por edhe takimeve raportuese e koordinuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përbushur me efektivitetet të gjitha rekomandimet apo kërkesat e ardhura në kuadër të raportimeve në kuadër të procesit të integritetit duke marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet:

- Nënkomiteti BE – Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri, në Bruksel, 20 mars 2024;
- Takimet bilaterale për shtetin e së drejtës, Bruksel 21 mars 2024;
- Këshillit Kombëtar i Integritetit Evropian;
- Tryezat e organizuara nga Ministri i Drejtësisë në kuadër të Pozicionit të përbashkët të BE-së.

Ndërkohë që në nivel teknik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcaktuar dy punonjës për të ndjekur dhe marrë pjesë në të gjitha takimet raportuese e koordinuese, për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, të cilët kanë ndjekur të gjitha takimet me prezencë dhe online në kuadër të angazhimeve të Kapitullit 23. Gjithashtu në kuadër të Kapitullit 23, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në cilësinë e institucionit kontribues, ka përcjellë kontribut lidhur me:

- Progres Raportin për Shqipërinë – 1 raport.
- Kontribut për rekomandimet e Nënkomitetit për Drejtësi Liri dhe Siguri – 1 raport.
- Raportin për Shtetin e së Drejtës të BE-së – 2 raporte.
- Piketat e Ndërmjetme në kuadër të Pozicionit të përbashkët i BE-së, – 1 raport.
- Përditësimet e të dhënave për periudha të ndryshme raportimi – 3 raporte.
- Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian”, për Grupkapitullin 1, “Themeloret” 2 takime shpjeguese dhe 2 takime koordinuese pranë Ministrisë së Drejtësisë.

V ORGANIZIMI I BRENDSHËM

5.1 Komandime nga KLGJ

Në plotësim të strukturës organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendeve vakante në njësinë e inspektorëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë përmes shkresës nr. 1445 prot., datë 24.05.2024 ka paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesën për nisjen e procedurave për komandimin e 3 (tre) magistratëve gjyqtarë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 284, datë 29.05.2024 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” ka vendosur hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura për komandim të gjyqtarëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për 3 (tre) pozicione të lira, duke përcaktuar afatin e paraqitjes së kërkesave në plotësim të dokumenteve përkatëse. Në këtë vendim janë përcaktuar edhe kohëzgjatja, kushtet, kriteret dhe kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të komandimit.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm 1 (një) kërkesë, për të cilën KLGJ-ja ka vijuar me vlerësimin e kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në pikat 2 deri në 7, të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me vendimin nr. 700, datë 03.12.2024^[11] “Për kualifikimin e kandidates znj. {--} për t’u komanduar në pozicionin “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është kualifikuar kandidatura e paraqitur. Pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur edhe opinionimi i KLGJ-së sa i takon komandimit të kandidatit, për të cilin ILD për këtë periudhë raportimi e ka pasur në proces vlerësimi, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 54, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5.2 Komandime nga KLP

Në vijim të plotësimit të strukturës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të vendeve vakante në njësinë e inspektorëve, ILD, i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë me shkresën nr. 1445/1 prot., datë 24.05.2024 për nisjen e procedurave për komandimin e 3 (tre) magistratëve prokurorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndërsa KLP ka

¹¹ I aksesueshëm në linkun vijues: <https://klgj.al/media/qufawuhl/vendim-nr-700-dat%C3%AB-03-12-2024-p%C3%ABr-kualifikimin-e-kandidates-znj-p%C3%ABr-t-u-komanduar-n%C3%AB-pozicionin-inspektor-n%C3%AB-zyr%C3%ABn-e-inspektorit-t%C3%AB-lart%C3%AB-t%C3%AB-drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

proceduar me njoftimin^[12] për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e prokurorëve për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të një magjistrati me detyrë prokuror.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë^[13] me vendimin nr. 274, datë 23.12.2024, ka iniciuar procedurën e verifikimit të përmbushjes së kushteve ligjore të kandidimit për komandimin e një prokurori në pozicionin e inspektorit magjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Procedurë e cila gjatë periudhës së hartimit të këtij raporti vijon në proces.

Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur si shqetësim edhe në raportet e mëparshme të veprimtarisë, se mungesa e inspektorëve magjistratë, është faktor me ndikim të lartë në ushtrimin e funksioneve të këtij institucioni. Mungesa e plotësimit të vendeve vakante, ndikon në proceset e punës, siç janë procesi i hetimit disiplinor, inspektimet tematike, si dhe trajtimit në kohë të numrit të lartë të ankesave sipas dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5.3 Rekrutim i inspektorëve jomagjistratë

Gjatë vitit 2024, në zbatim të neneve 209 dhe 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, si dhe të Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 27.05.2024 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shpallur procedurën për 4 (katër) pozicione vakante për inspektorë jomagjistratë në Njësinë e Inspektorëve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përcaktuar si afat për shprehje interesi datën 26.06.2024. Procedura e verifikimit është në zhvillim/proces.

Shpallja është bërë publike në faqen zyrtare elektronike të institucionit, në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në stendat e informimit për publikun. Pas përfundimit të afatit 1 (një) mujor për shprehje interesi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 74, datë 26.06.2024 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ka ngritur

¹² I aksesueshëm në linkun vijues: <https://klp.al/2024/10/28/njoftim-per-shprehje-interesi-per-komandimin-e-l-nje-prokurori-prane-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë-permes-procedures-se-komandimit-te-prokuroreve/>

¹³ I https://klp.al/wp-content/uploads/2025/01/v.nr._274.pdf

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, i cili në datën 03.07.2024 ka filluar procedurën përzgjedhëse duke njoftuar 19 kandidatët, të cilët kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe duke publikuar në faqen zyrtare të institucionit njoftimin mbi fillimin e procedurës përzgjedhëse.

Në vijim të procedurës përzgjedhëse në përputhje me vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, pas përmbushjes së detyrimit ligjor për pajisjen e kandidatëve me formularët përkatës dhe dorëzimit të formularëve të plotësuar nga kandidatët pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimeve të Inspektorëve ka vijuar me dërgimin e shkresave zyrtare pranë institucioneve përkatëse, me qëllim marrjen e informacionit, mbi të cilin do të bazohet verifikimi i plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimi i figurës e i pasurisë.

Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit nga institucionet përkatëse, do të vijohet me fazat e mëtejshme të procedurës përzgjedhëse për kandidatët, që kanë shprehur interes për pozicionin inspektorë jomagjistratë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

Aktualisht procesi është ende në fazën e marrjes së informacionit, mbi të cilin do të bazohet verifikimi i plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimi i figurës e i pasurisë.

5.4 Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2024, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit të Punës dhe ligjit organik, janë realizuar në total 14 emërime/rekrutime brenda strukturës së miratuar, 9 (nëntë) lirime, si më poshtë:

1. Kabineti	1 (një) Sekretar i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë).
2. Inspektor Magjistrat	1 (një) rikthim në detyrë magjistrati me profil “Prokuror” pas vendimit nr. 7 (JR), datë 22.02.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Inspektor jomagjistrat 1 (një) lirim me dorëheqje.
3. Niveli i Lartë Drejtues	0 (zero)
4. Niveli i Mesëm Drejtues	4 (katër) emërime për pozicionin Ndihmës

- Inspektor, nga të cilët, 2 (dy) pozicione janë plotësuar me lëvizje paralele, 1 (një) pozicion është plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe 1 (një) pozicion me pranim nga jashtë shërbimit civil, nga 4 pozicione të lira të krijuara gjatë vitit, për shkak të dorëheqjeve me kërkesë të nëpunësve.
5. Niveli i Ulët Drejtues 1 (një) emërim në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Statistikave, Drejtoria e Analizës dhe Standardeve nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.
6. Niveli ekzekutiv 5 (pesë) emëtime, nga të cilët 2 (dy) me lëvizje paralele dhe 3 (tre) me pranim në shërbim civil, si dhe 3 (tre) lirime (për shkak të emërimit të nëpunësve në institucione të tjera pjesë e shërbimit civil).
7. Punonjës mbështetës 2 (dy) emëtime dhe 1 (një) lirim për shkak të mbushjes së moshës së pensionit.

Totali i emërimeve për vitin 2024 brenda strukturës së miratuar është 14 (katërmëdhjetë) punonjës/nëpunës dhe 9 (nëntë) lirime.

Numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2024 është 101 punonjës të miratuar. Totali i punonjësve që kanë ushtruar detyrën gjatë vitit 2024 është 84.

5.5 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2024, në drejtim të rritjes së kapaciteteve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka maksimizuar përpjekjet për të gjetur dhe mundësuar zhvillimin profesional duke vijuar bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë për shkëmbimin e eksperiencave në fushën e hetimeve dhe inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë së bashku me njësinë e inspektorëve dhe njësinë e ndihmës inspektorëve kanë ndjekur një sërë trajnimesh dhe kanë realizuar shkëmbime eksperiencash, duke u fokusuar në zhvillimin profesional, si edhe standardizimin dhe unifikimin e praktikës së veprimtarisë inspektuese.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga krijimi i institucionit.

Sa i përket veprimtarisë trajnuese gjatë vitit 2024, në kuadër të forcimit të kapaciteteve, janë zhvilluar trajnimet dhe vizita studimore si më poshtë:

Në muajin shkurt, njësia e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë në trajnimin e targetuar mbi identifikimin dhe adresimin e çështjeve të konfliktit të interesit në kuadrin e hetimit disiplinor, organizuar nga misioni i ekspertëve të projektit EU4Justice, që asiston ILD-në.

Në muajin prill, inspektorë dhe ndihmës inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në dy ekipe zhvilluan dy vizita njëjavore pune në Mbretërinë e Spanjës. Vizitat studimore janë pjesë e mbështetjes së projektit EU4Justice, që synon rritjen e kapaciteteve dhe përfitim të eksperiencave nga institucionet homologe evropiane. Përveç marrjes së eksperiencës profesionale, vizitat e punës shërbyen edhe për forcimin e bashkëpunimit me Shërbimin Spanjoll të Inspektimit, me të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mars 2023.

Gjithashtu, njësia e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si pjesë e forcimit të kapaciteteve të inspektimit me mbështetjen e projektit EU4Justice, morën pjesë në trajnimin me fokus *“Praktikat e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), mbi përgjegjësitë disiplinore dhe lirinë e të shprehurit të magistratëve*, si pjesë e forcimit të kapaciteteve të inspektimit me mbështetjen e projektit EU4Justice.

Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës janë përcjellë pranë SHM formularët e aplikimit për pjesëmarrje në sesionet e trajnimit vazhdues për periudhën 2024-2025 për inspektorët dhe ndihmës inspektorët. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë kryer një numër i konsiderueshëm trajnimesh gjatë vitit 2024 nga inspektorë dhe ndihmësinpektorë.

Gjatë muajit qershor, metodologjia e përgatitjes, kryerjes dhe analiza e inspektimeve klasike tematike ishin në fokus të aktivitetit trajnues 5 ditor, që u zhvillua në Tiranë dhe Durrës, me pjesëmarrjen e njësive të inspektorëve dhe njësive të ndihmës inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Një ekip i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i përbërë nga inspektorë, ndihmës inspektorë dhe anëtarë të kabinetit, zhvilloi një vizitë studimore 5 ditore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, në Paris, me mbështetjen e Expertise France dhe EU4Justice. Gjatë vizitës u zhvilluan sesione prezantimi mbi etikën dhe procedurën paradisiplinore të magistratëve, si dhe hetimet administrative, metodologjia, të drejtat e mbrojtjes, teknikat e objektivizimit, që u pasuan me diskutime profesionale me ekipin e ILD-së.

Në muajin tetor, Njësia e Inspektorëve dhe Ndhmës Inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një trajnim 3 ditor në Tiranë, mbi rritjen e efikasitetit të ILD-

së, në drejtim të inspektimeve tematike dhe institucionale, mbështetur nga projekti EU4Justice.

Në muajin dhjetor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i shoqëruar nga njësia e inspektorëve, zhvilloi një vizitë dyditore pune pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg (Francë). Delegacioni shqiptar zhvilloi sesione profesionale pune me gjyqtarë dhe juristë të GJEDNJ-së, mbi procesin disiplinor dhe lidhjen e tij me pavarësinë e magjistratëve si dhe paraqitje e diskutime të neneve 8, 10 dhe nenit 6, pjesa civile, mbi standardet e punës në kontekstin e procedimeve disiplinore.

Në kuadër të veprimtarisë trajnuese, nga nëpunësit civil të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë ndjekur trajnime të gjithë punonjësit/nëpunësit e të gjitha niveleve, në total janë ndjekur 63 trajnime të ofruara nga ASPA (për nëpunësit civil) dhe 16 trajnime me ekspertë të huaj & 8 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (inspektorë dhe ndihmës inspektorë).

VI TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më 31 dhjetor 2024, ka marrë pjesë në proceset si më poshtë:

6.1 Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 1/2024, datë 16.02.2022, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë Gjyqësor me kërkues magjistratin M. M., me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me objekt: *“Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 180, datë 09.04.2024, të KLGJ-së deri në përfundimin e gjykimit në Kolegj me vendim përfundimtar”*; *“Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 180, datë 09.04.2024, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor me të cilin është vendosur shkarkimi nga detyra i magjistrates M. M., gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare të pagës dhe të përfitimeve nga magjistratja M. M.”*.

Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda afatit të caktuar nga KPA janë depozituar parashtrimet rreth çështjes.

Kjo çështje është në shqyrtim dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar.

6.2 Procese gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Çështje gjyqësore me palë paditëse: M. Z., S. M., L. Z., D. S., etj.; të paditur: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: *“Detyrimin e të paditurve të rillogarisin dhe paguajnë diferencën e pagës së papaguar për periudhën 01.01.2019 e në vijim”*; *“Detyrimin e të paditurve të paguajnë 10 % interes ligjor mbi shumën e papaguar deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi”*; *“Shpenzimet gjyqësore, duke përfshirë dhe shpërblimin e avokatit, t’i ngarkohen palëve të paditura”*; *“Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm”*.

Kjo çështje është në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën nuk është caktuar ende një datë për shqyrtimin e saj.

6.3 Procese gjyqësore të përfunduara apo në fazë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

1. Çështje gjyqësore administrative, e regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 6334, datë 01.12.2023, me palë paditëse: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të paditur: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit administrativ nr. 5213, datë 20.11.2023 të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë për dënimin me gjobë. Detyrimin e të paditurit IMT Bashkia Tiranë të kthejë shumën prej 100.000 lekë, të paguar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas vendimit nr. 5213, datë 20.11.2023”*.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 876, datë 27.03.2024 ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 5213, datë 20.11.2023 për dënimin me gjobë, të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë. Detyrimin e të paditurit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë, t'i kthejë shumën prej 100.000 lekë, të paguar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas vendimit nr. 5213, datë 20.11.2023. Vendimi përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet zyra e shërbimit përmbarimor, ekzekutim i cili të kryhet me marrjen e vendimit formë të prerë. Vendimi është i formës së prerë. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim”*.

2. Çështje gjyqësore administrative, e regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 4045/5915, datë 22.06.2023 Regj, me palë paditëse: Komiteti Shqiptar i Helsinikit; të paditur: Inspektori i Lartë i Drejtësisë; me objekt: *1. Shfuqizimin e vendimit të KLGJ-së nr. 19 prot., datë 25.04.2023 “Për refuzimin e ankimit të Komitetit Shqiptar të Helsinikit, kundër vendimit nr. 312/1 prot., datë 30.01.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 312 prot., datë 30.01.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinikit, përsa i përket pretendimeve ndaj magjistratëve Kastriot Gramshi dhe Arben Mickaj dhe përfundimin për vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit, përsa i përket pretendimeve ndaj ish-magjistratit Bedri Qori”. 3. Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të marrë në shqyrtim dhe të zhvillojë hetime si dhe të shprehet me vendim përfundimtar mbi ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinikit”*.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 2607, datë 09.07.2024 ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesëpadisë, pasi jemi përpara një kërkesëpadie të depozituar kundër një vendimi/akti administrativ të paankimueshëm, sipas akteve normative në fuqi”*.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në datë 20.09.2024. Mbi bazën e këtij ankimi çështja aktualisht ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk është shqyrtuar ende.

VII TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN^[14]

7.1 Qytetari i informuar në vëmendje të ILD-së

Edhe gjatë vitit 2024, komunikimi publik i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar të ketë në fokus transparencën dhe mirinformimin, si mënyra për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në institucion dhe adresimin e saktë të pretendimeve të tyre, sa i takon kompetencave të ILD-së. Edhe në komunikim, institucioni ka ndjekur parimin për gjetjen e balancës mes interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve, pasi sa më i pavarur magjistrati, aq më i garantuar qytetari për të drejtat e tij.

Strategjia e komunikimit publik të institucionit synon që informacioni i grumbulluar përmes ndërveprimit sistematik me qytetarë, grupe interesi e institucione, të përkthehet në plane veprimi e aktivitete, për të adresuar sfidat e konstatuara në drejtim të informimit të qytetarëve dhe sensibilizimin e tyre, bazuar në objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin strategjik, planin e integritetit etj.

Duke vendosur si prioritet kryesor të programit për edukimin, informimin e sensibilizimin e qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar të punojë sistematikisht për të rritur besimin tek çdo aktor publik, mediatik apo grup interesi, përmes informimit të vazhdueshëm mbi kompetencat dhe funksionet e institucionit.

Eshtë hartuar një program i detajuar për informimin, edukimin ligjor dhe sensibilizimin e qytetarëve. Plani është ndërtuar bazuar në nevojat e konstatuara dhe sugjerimet e marra nga takimet fizike me qytetarë, nga anketa e publikuar në faqen e internetit, komunikimi përmes linjës telefonike, si dhe të dhënat që janë mbledhur përmes ankesave, informacioneve të ndryshme dhe përmes rrugëve të tjera të informimit publik. Ky program ka të përcaktuar qëllimet dhe objektivat kryesore, që lidhen kryesisht me edukimin ligjor, mbi kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në veçanti dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi, me qëllim informimin e qytetarëve dhe sensibilizimin e tyre, bazuar në objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin strategjik, planin e integritetit etj.

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut është premisë për krijimin e lehtësive në minimizimin e fluksit të ankesave, të cilat janë jashtë objektit të veprimtarisë, apo nuk përmbushin kushtet ligjore të pranueshmërisë si ankesë.

Analizimi i të dhënave, referuar tërësisë së mjeteve të komunikimit, si takimet me grupe interesi, aktivitete të ndryshme, informacion mediatik, komunikim me organizata të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut e shtetin e së drejtës, i shërben Zyrës së Inspektorit të

¹⁴ Çdo aktivitet publik i Zyrës së ILD-së gjendet i pasqyruar në faqen zyrtare të institucionit në shqip dhe anglisht.

Lartë të Drejtësisë për të targetuar përpjekjet jo vetëm për informim, por edhe në rritjen e besimit publik tek Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe më tej tek sistemi i drejtësisë.

Natyrisht suksesi i zbatimit të programeve të ndryshme për edukimin ligjor, informimin dhe sensibilizimin është një proces kompleks, që kërkon durim e përkushtim sistematik, pasi suksesi ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë, bashkëveprues në këtë fushë, me të cilët Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka marrëveshje bashkëpunimi, apo që mund të ketë në të ardhmen.

7.2 Pritja e qytetarëve në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Krahas informimit dhe mundësisë së ankimimit përmes faqes zyrtare të internetit, qytetarët apo subjektet, mirëpritën çdo ditë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si për t'u informuar, ashtu edhe për të depozituar një ankesë, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, që realizon pritje me qytetarët në çdo ditë zyrtare pune, nga ora 09.00-14.00, por edhe u përgjigjet interesimit të qytetarëve apo institucioneve përmes numrit zyrtar të telefonit.

Gjatë vitit 2024 janë asistuar dhe informuar nëpërmjet takimeve dhe linjës telefonike në lidhje me pretendimet/ankimet e tyre për magjistratët, mesatarisht (dy) qytetarë në ditë.

Konkretisht:

- Janë realizuar 271 takime me qytetarë, (mbi bazën e kërkesave me shkrim, të kërkesave më anë të komunikimit me telefon, si dhe pa lënë takim të mëparshëm). Gjatë takimeve, në çdo rast nëpunësit përgjegjës kanë dëgjuar pretendimet, duke i asistuar/informuar për paqartësitë, në lidhje me të drejtat e qytetarëve për t'u ankuar, rrugët se si mund të bëjnë një ankesë, afatet për trajtimin e saj, mënyrën sesi mund të informohen rreth ankesës së tyre etj.
- Janë asistuar përmes telefonit, në numrin zyrtar të institucionit 197 qytetarë/subjekte të interesuar, të cilët kryesisht kanë kërkuar informacion mbi fazën në të cilën ndodhen ankesat, mënyrën se si pranohen, si procedohet me paraqitjen e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve të tyre, etj.

7.3 E drejta e informimit

Edhe gjatë vitit 2024, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka përmbushur në afat detyrimin ligjor, që rrjedh nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe nga miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar. Është përditësuar sipas afateve regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas urdhërimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Informacioni i bërë publik në programin e transparencës, pasqyron në mënyrë shteruese veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare www.ild.al si dhe në mjediset e zyrës për pritjen e qytetarëve.

Gjatë vitit 2024 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 137 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda afateve ligjore. Kërkesat për informacion kategorizohen si më poshtë:

Viti 2024	
Kërkues	Numri i kërkesave për informacion
Persona fizikë	123
Media	11
Persona juridikë	3
Total	137

Asnjë kërkues nuk rezulton të jetë ankuar në autoritetet përkatëse për:

- a) *mungesë informacioni;*
- b) *informacion të paqartë;*
- c) *tejkallim të afateve ligjore;*
- ç) *refuzim të dhënies së informacionit.*

7.4 Komunikimi i targetuar publik

Në funksion të transparencës mbi veprimtarinë e institucionit, por edhe aksesin e publikut, edhe gjatë vitit 2024, në strategjinë e komunikimit të ILD-së janë përdorur mënyrat klasike të komunikimit, duke përmirësuar elementë për rritjen e efikasitetit të punës, në funksion të informimit mbi rolin dhe funksionet e ILD-së.

7.4.1 Faqja zyrtare e internetit

Faqja zyrtare e internetit dygjuhëshe, shqip dhe anglisht (www.ild.al; <https://ild.al/en/home/>) është mjeti kryesor zyrtar i komunikimit të ILD-së me publikun, në funksion të një marrëdhënieje proaktive dhe transparente.

Informimi përmes faqes bëhet në kohë reale me çdo veprimtari të institucionit, me rubrika të dedikuara mbi aktet, vendimet, procedurat e punës dhe aktivitetin e Zyrës së Inspektorit të

Lartë të Drejtësisë, apo të dhëna të tjera që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me qytetarin, si formulari i ankesës, anketa dhe të dhëna të tjera të detajuara informuese. Faqja përmirësohet herë pas here në funksion të lehtësimit të identifikimit të informacionit të bollshëm që përmban, por edhe të thjeshtimit të përdorimit të saj nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, në kërkim të informacionit në kohë reale.

Kështu, rubrika *“Si pranohen ankesat”*, rifreskohet me raste konkrete orientuese për ankuesit mbi kushtet ligjore të pranueshmërisë së ankesës, ecurinë e saj, arkivimin, ankimin e deri tek hetimi e procedimi disiplinor, me një ilustrim grafik të të gjithë rrugëtimit, që ndjek një ankesë në ILD. Ky informacion i përditësuar plotëson atë ekzistues, për lehtësim të procesit të ankimit përmes formularit tip të ankesës, me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij, një model tip të plotësuar orientues dhe plot 4 mënyra dërgimi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: përmes celularit ose kompjuterit, me e-mail, me postë ose fizikisht në institucion. Ankuesi mund të përzgjedhë vetë formën që preferon për dërgimin e ankesës.

“Pyetje të shpeshta mbi procesin e ankimit”, është rubrika e krijuar në faqen e internetit, për t’iu përgjigjur paqartësive të konstatuara nga komunikimet me qytetarë/ankues, si një element i shtuar i transparencës në informimin publik mbi procesin e ankimit në ILD, me përgjigje se si dhe ndaj kujt mund të ankohesh në ILD, si procedohet me ankesën, ecuria e saj etj.

Çdo të hënë, në faqen zyrtare pasqyrohet në shifra, puna e bërë gjatë një jave në institucion me përpunimin e ankesave, që nga ato të depozituara, të proceseve të shqyrtimit, verifikimit, hetimit e procedimit disiplinor.

Edhe gjatë vitit 2024 *“Anketa mbi veprimtarinë e ILD-së”*, vijoi të përdorej nga qytetarët, si një mjet, që institucioni e përdor për të marrë vlerësime mbi punën e vet, bazuar në eksperiencën e përvoja konkrete dhe sugjerime për përmirësime.

Në harkun kohor të një viti janë plotësuar nga përdorues të ndryshëm 27 anketa online.

Buletini informativ edhe gjatë vitit 2024 ka vijuar të jetë një mënyrë sistematike komunikimi publik lidhur me aktivitetin mujor të institucionit, në shqip dhe anglisht, me të dhëna të detajuara mbi aktivitetin mujor edhe sa i takon procesit të ankesave.

7.4.2 Komunikimi me masmedian

Edhe gjatë vitit 2024 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar komunikimin e qëndrueshëm me mediat, si mënyrë për të arritur tek publiku, duke u përpjekur t’u përcjellë informacion në kohë reale mbi veprimtarinë e institucionit, duke iu përgjigjur interesimit mbi aspekte të ndryshme të punës së ILD-së, e duke i monitoruar, me qëllim vjeljen e

informacionit mbi denoncimet e ndryshme për rastet e shkeljeve të pretenduara disiplinore të magjistratëve.

7.4.3 Rrjetet sociale

Komunikimi përmes rrjeteve sociale ka pasur vëmendje të shtuar gjatë vitit 2024, në kushtet kur ato janë kthyer në platforma informimi masiv për përdorues të çdo moshe. Përveç Twitter dhe YouTube, institucioni ka një llogari në Facebook, me synim informimin e përdoruesve rreth rolit dhe funksioneve të Zyrës së ILD-së. Edhe pse faqja ka karakter vetëm informues, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun që e administron, u është përgjigjur kërkesave për asistencë nga qytetarë të ndryshëm, duke i orientuar bazuar në legjislacionin përkatës.

7.5 Edukimi ligjor si mënyrë direkte komunikimi

Gjatë vitit 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka intensifikuar praktikën e komunikimit me grupe të ndryshme shoqërore në funksion të edukimit ligjor mbi rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së ILD-së dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

- Edukimi ligjor përmes *medias* ka targetuar dinamikat që kanë pasur në fokus sistemin e drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kushtuar vëmendje të posaçme sqarimit publik mbi mënyrat se si aktivizohet Zyra e ILD-së për denoncimet publike, një proces që vijon edhe në vitin 2025. Në komunikimin publik Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka evidentuar detyrimin institucional për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me të dhëna apo informacione publike, në raport me shkelje të pretenduara disiplinore nga ana e magjistratëve, duke nënvizuar se interesi i publikut/medias për administrimin e drejtësisë, duhet të shkojë paralel me respektimin e pavarësisë së magjistratëve, si një balancë që i jep vlerë shtetit të së drejtës.

Pjesë e komunikimit publik përmes mediave ka qenë edhe sqarimi i metodologjisë së punës së ILD-së, në raport me trajtimin e ankesave, që bëhet sipas një radhe përparësie të bazuar në kriteret si koha, tipologjia apo urgjenca e trajtimit, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesës.

- Edukimi ligjor ka targetuar edhe *kategori të tjera shoqërore*, pasi Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe ekipi i tij ka krijuar një traditë për paraqitjen e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, përmes bashkëbisedimeve të hapura lidhur me rolin, veprimtarinë, por edhe objektin e punës së ILD-së, por edhe mënyrën se si shihet institucioni prej tyre.

VIII PERFORMANCA FINANCIARE

Me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u miratua një buxhet prej **347.3 milionë lekë**, nga i cili:

1. Për Shpenzime korrente 274.3 milionë lekë.
2. Për Shpenzime kapitale 73 milionë lekë.

Ky buxhet, duke qenë në nivele të ulëta në krahasim me kërkesat e PBA, u rishikua gjatë vitit, e konkretisht:

- Në shpenzimet korrente, për akomodimin e plotë të nevojave të institucionit në zërin “Shpenzime operative”, u mundësua nëpërmjet transferimit nga kursimet në fondin e pagave, shtesa e fondit prej 11.5 milionë lekë. Gjithashtu, me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, fondet e lira në zërin “Paga” u pakësuan me 20 milionë lekë.
- Në shpenzimet kapitale, me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, u miratua shtesa e fondit prej 66 milionë lekë, për mbulimin e plotë të kostos së punimeve të rikonstruksionit të godinës.

Në mbyllje të vitit, buxheti i rishikuar i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është **393.6 milionë lekë, me një realizim në vlerën 361.9 milionë lekë, ose në masën 91.9%.**

I detajuar sipas treguesve buxhetore në nivel grup-shpenzimesh, ky realizim është si më poshtë:

<u>Zërat:</u>	<u>Plani</u>	<u>Realizimi</u>	
	<i>(mln lekë)</i>	<i>(mln lekë)</i>	<i>(% ndaj planit)</i>
1. Shpenzime korrente	254.6	223.7	87.9%
2. Shpenzime kapitale	139	138.2	99.4 %
TOTAL BUXHETI 2024	393.6	361.9	91.9%

Në grupin e shpenzimeve korrente, impakti kryesor në realizimin e buxhetit në masën 87.9%, ka pasur vakanca për 6 vende në pozicionin “Inspektor magjistrat” dhe 5 vende për pozicionin “Inspektor jomagjistrat”. Për këtë arsye, në rishikimin e buxhetit të vitit 2024, fondi i pagave u reduktua në vlerën 20 milionë lekë. Nga ana tjetër, kjo situatë ka krijuar mundësinë, që nga fondet e lira në grupin e shpenzimeve të personelit, të sigurohet shtesa prej 11.5 milionë lekë e kërkuar për shpenzime operative, duke akomoduar në këtë mënyrë mbulimin e të gjitha nevojave në kufijtë e kërkesave të PBA 2024-2026 në këtë zë.

Përsa i përket grupit të shpenzimeve kapitale, buxheti i rishikuar për vitin 2024, i realizuar në masën 99.4%, mundësoi realizimin e projekteve të investimeve si më poshtë:

- Rikonstruksioni i zyrave dhe ambienteve të ILD. Në ligjin vjetor të buxhetit 2024, u planifikua fondi në vlerën 63 milionë lekë. Shtesa e miratuar prej 66 milionë lekë me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, duke e çuar në vlerën 129 milionë lekë buxhetin në këtë projekt, bëri të mundur mbylljen e punimeve të rikonstruksionit, brenda afatit të parashikuar në modifikimin nr. 1, datë 28.12.2023 të kontratës së zbatimit.
- Blerja e 2 automjeteve, me një realizim në vlerën 6.5 milionë lekë për nevoja të inspektimit.
- Blerja e pajisjeve dhe orendive më të domosdoshme për ambientet e rikonstruktura, si raftet e arkivës, etj., me një realizim në vlerën 2 milionë lekë.

Gjatë vitit 2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit kreu auditimin financiar të ILD për periudhën 01.01.2021-31.12.2023. Në raportin përfundimtar të auditimit, vlerësohet rregullsia dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor për sa i përket informacionit të pasqyrave financiare, të cilat, siç shprehet në opinionin e auditimit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit referuar kuadrin rregullator në fuqi. Në këtë raport, grupi i auditimit ka lënë vetëm 3 rekomandime, organizative nga të cilët, rekomandimi nr. 1, lidhet me marrjen e masave për plotësimin e strukturës organizative të ILD, rekomandimi nr. 2, për marrje të masave nga ana e strukturave përgjegjëse gjatë procesit të parashikimit, zbatimit dhe rishikimit të buxhetit vjetor, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta të zërave të planit buxhetor gjatë vitit, rekomandimi nr. 3, për marrjen e masave për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve në institucion, e cila i referohet gjetjes së moskryerjes së inventarizimit të aktiveve për vitin 2023; kjo, pasi institucioni për shkak të rikonstruksionit, u transferua në ambiente të tjera dhe shtyrja e afateve të punimeve të rikonstruksionit solli për pasojë mosrealizimin e këtij detyrimi ligjor për vitin 2023.

Për zbatimin e 3 rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të KLSH, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka hartuar planin e masave dhe të aktiviteteve, të cilat ndiqen në vijimësi nga strukturat e ngarkuara.

IX. PËRMBLEDHJE TË ARRITJEVE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vitin e pestë të punës, edhe pse me burime njerëzore inspektuese të kufizuara, rendit disa arritje të rëndësishme me ndikim të drejtpërdrejtë në sistem.

Konkretisht:

1. Përmes mekanizmave të inspektimeve tematike, shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, verifikimit me iniciativë, analizimit të informacioneve periodike të marra nga gjykatat, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është aktiv në sistemin e kontrollit të punës së magjistratëve, në përputhje me balancën që duhet të ekzistojë sipas parimit të ndarjes së pushteteve, duke përcaktuar standarde për një sistem drejtësie funksional llogaridhënës, të përgjegjshëm, të paanshëm dhe me integritet.
2. Rritje e numrit të hetimeve të ndërmarra me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë vitit 2024, me iniciativë ka kryer edhe dy hetime, objekti i të cilave ka qenë papajtueshmëria dhe konflikti i interesit të cilat janë bërë shkak edhe për kontrollin e pasurisë të këtyre dy subjekteve pranë organeve kompetente për pasurinë, tatimet, regjistrat e pasurive, regjistrat e lejeve dhe licencave dhe organeve të tjera, veprimtaria e së cilave lidhet me faktet dhe objektin e hetimit.
3. Përmirësimi i procesit të hartimit të planit të inspektimeve, duke rritur efencën e burimeve njerëzore dhe forcimin e bashkëpunimit me organet e sistemit të drejtësisë për tematika inspektimi.
4. Numër i rritur i inspektimeve me tematika të fokusuara për cilësinë dhe efencën e sistemit gjyqësor dhe numër i lartë i inspektimeve të përfunduara.
5. Adresimi i problematikave të evidentuara në inspektimet tematike, përmes rekomandimeve dhe mekanizmit të monitorimit të ndjekjes së tyre. Reagimi i organeve të inspektuara ka qenë i lartë duke siguruar ndjekjen e rekomandimeve të cilat janë nën përgjegjësinë e tyre dhe përcjelljen e informacioneve përkatëse.
6. Rekomandimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë gjetur mbështetje nga organet e sistemit të drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Shkolla e Magjistraturës, të cilët kanë reaguar duke marrë masa të brendshme për të adresuar rekomandimet.
7. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar profesionalizimin e magjistratëve, duke kryer verifikimin e pretendimeve të ankesave, në përfundim të të cilave ka arritur në konkluzionin se faktet e zbuluara, nuk justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve, por që mund të jenë objekt i vlerësimit etik dhe profesional të tyre, andaj edhe i janë përcjellë këshillave për vlerësim.
8. Rritja e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë duke rritur numrin e takimeve të punës në veçanti për tematikat e inspektimit, por edhe adresimi i sfidave që lidhen me komunikimin institucional për forcimin e një sistemi drejtësie efikas dhe më të qëndrueshëm.

9. Përfundimin e vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve jomagjistratë, duke i hapur rrugë vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve magjistratë.
10. Rritje të numrit të trajnimeve ndaj inspektorëve dhe ndihmës inspektoreve, përmes kurrikulave të Shkollës së Magjistraturës dhe bashkëpunimeve me aktorë ndërkombëtarë.
11. Vlerësimi i veprimtarisë së ILD-së, në funksion të llogaridhënies së magjistratëve, është evidentuar edhe nga Progres Raporti për Shqipërinë në vitin 2024, duke vënë theksin tek funksionimi i ILD-së dhe progresi i mirë i vazhdueshëm në zbatimin e reformave në drejtësi kanë forcuar përgjegjshmërinë në të gjithë sistemin e drejtësisë^[15]. kanë evidentuar kontributin e ILD-së në forcimin e llogaridhënies së magjistratëve, duke vënë theksin tek funksionimi i kënaqshëm i ILD-së dhe progresi i mirë i vazhdueshëm në zbatimin e reformave në drejtësi kanë forcuar përgjegjshmërinë në të gjithë sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, vlerësimet kanë nënvizuar përfundimin e shqyrtimit të fondit të ankesave të trashëguara (backlog) dhe nevojën për të vijuar me fuqizimin e inspektimeve tematike, si një prioritet kyç për rritjen e transparencës dhe efektivitetit të sistemit.

¹⁵ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf faqe 29-30.

X NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2023

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në respektim të vendimeve nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, si dhe bazuar në ecurinë e punës së ILD-së, ka bërë një vlerësim të detajuar të raportit vjetor të punës të depozituar pranë tij nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Në seancën plenare të datës 25 korrik 2024, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2023”, përmes së cilës janë lënë për ndjekje dhe zbatim 8 rekomandime.

Me miratimin e rezolutës, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar kalendari i masave për zbatimin e rekomandimeve, janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e masave për secilin rekomandim dhe afatet përkatëse për përmbushjen e rekomandimeve.

Nga rekomandimet e lëna sipas rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre, vëmë në dijeni se janë përmbushur plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna.

Për sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra në zbatim të tyre, në mënyrë të detajuar informojmë sa vijon:

- 1. Të adresojë nëpërmjet instrumenteve që i jep ligji të problematikave të ndjeshme për publikun, si institucion garantues i sistemit të drejtësisë, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të besimit të publikut jo vetëm për ILD-në, por për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.*

Ky rekomandim është i plotësuar nëpërmjet përfshirjes në planin e inspektimeve të problematikave të dala nga shqyrtimi i ankesave. Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar planin vjetor të inspektimeve, miratimi i të cilit ka ardhur si rrjedhojë e marrjes në konsideratë të problematikave të evidentuara nga shqyrtimi i ankesave, vlerësimi i pretendimeve më të shpeshta për shkelje të ndryshme nga ana e magjistratëve, administratës së gjykatave apo prokurorive. Gjithashtu në konsideratë janë marrë edhe propozimet e ardhura nga institucionet të cilat në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, por edhe në mbështetje të dispozitave të zbatueshme që parashikojnë ndërmarrjen e inspektimeve.

Plani vjetor i inspektimeve i është nënshtruar diskutimeve në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve, ku janë analizuar të dhënat nga pretendimet e përcjella nga publiku, të dhënat që kanë përcjellë institucionet e ndryshme gjatë vitit, angazhimet apo detyrimet që kanë lindur nga procesi i integritetit. Gjatë hartimit të planit, janë vlerësuar gjithashtu edhe mundësitë reale dhe objektive të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të realizuar inspektimet e planifikuara nisur nga numri i kufizuar i inspektorëve, por edhe të vonesave në marrjen dhe përpunimin e informacioneve, për shkak të volumit të dokumentacionit shkresor dhe pamundësisë për shkak buxheti të një sistemi elektronik që do të lehtësonte procesin e përpunimit të informacionit gjatë një inspektimi. Tematikat e inspektimit për planin e vitit 2024, janë tematika të cilat, lidhen me detyrimet ligjore që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që janë po aq sa edhe problematika të përcjella nga ankesat e publikut, si hedhja e shortit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë, caktimi i çështjeve në prokurori dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve. Nga ana tjetër planifikimi i disa tematikave, si ajo e dokumentimit të zbatimit të detyrimit ligjor nga gjykata për njoftimin e palëve për ndërmjetësimin, jo vetëm si një angazhim i qeverisë shqiptare me BE-në, por edhe si një mjet i kërkuar në kuadër të procesit të integritetit në funksion të përkrahjes/promovimit dhe rritjes së përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, si masa të dedikuara që lidhen me efikasitetin në gjyqësor, duke reduktuar numrin e çështjeve.

Përfshirja e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për zhvillimin e një inspektimi tematik mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është një tjetër tematikë që përkon me numrin më të lartë të ankesave të ardhura nga publiku. Për sa është rekomanduar për këtë çështje Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër të vlerësimit të kujdesshëm të tematikave ka adresuar problematikat e ndjeshme për publikun, gjatë miratimit të planit vjetor të inspektimeve.

2. Vëmendje e veçantë plotësimit të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat.

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ka dhënë vëmendje të veçantë procesit të plotësimit të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat. Krahas nevojës për ndryshime ligjore të kriterëve dhe aspekte të tjera që mund të rrisin interesin për aplikime në pozicionin e inspektorit, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë hartuar kërkesat drejtuar këshillave për komandimin e magjistratëve në pozicionin inspektor magjistrat konkretisht, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga kërkesa e paraqitur pranë KLGJ-së, kjo e fundit ka proceduar me njoftimin^[16] për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në datë 21.09.2023. KLGJ në vendimin nr. 284, datë 29.05.2024 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” ka vendosur hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura për komandim të gjyqtarëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për 3 (tre) pozicione të lira, duke përcaktuar afatin e paraqitjes së kërkesave në plotësim të dokumenteve përkatëse. Në këtë vendim janë përcaktuar edhe kohëzgjatja, kushtet, kriteret dhe kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të komandimit.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm 1 (një) kërkesë, për të cilën KLGJ-ja ka vijuar me vlerësimin e kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në pikat 2 deri në 7, të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me vendimin nr. 700, datë 03.12.2024^[17] “Për kualifikimin e kandidates znj. {--} për t’u komanduar në pozicionin “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është kualifikuar kandidatura e paraqitur. Pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur edhe opinioni i KLGJ-së sa i takon komandimit të kandidatit, për të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën e raportimit e ka pasur në proces vlerësimi, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 54, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërsa KLP ka proceduar me njoftimin^[18] për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e prokurorëve për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të një magjistrati me detyrë prokuror. Me vendimin nr. 274, datë 23.12.2024, Këshilli i Lartë i Prokurorisë^[19], ka iniciuar procedurën e verifikimit të përmbushjes së kushteve ligjore të kandidatit për komandimin e një prokurori në pozicionin e inspektorit magjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo procedurë rezulton të jetë në proces deri në momentin e konceptimit të këtij informacioni.

Në lidhje me rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 74, datë 26.06.2024 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

¹⁶ Nga konsultimi me faqen zyrtare të KLGJ, njoftimi mund të aksesohet në linkun vijues: <https://klgj.al/media/av3l2nqz/njoftim-i-dat%C3%ABs-29-05-2024-p%C3%ABr-shpalljen-e-k%C3%ABrkes%C3%ABs-p%C3%ABr-kandidatura-nga-radh%C3%ABt-e-gjyqtar%C3%ABve-p%C3%ABr-komandimin-n%C3%AB-zyr%C3%ABn-e-inspektorit-t%C3%AB-lart%C3%AB-t%C3%AB-drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

¹⁷ I aksesueshëm në linkun vijues: <https://klgj.al/media/qufawuhl/vendim-nr-700-dat%C3%AB-03-12-2024-p%C3%ABr-kualifikimin-e-kandidates-znj-p%C3%ABr-t-u-komanduar-n%C3%AB-pozicionin-inspektor-n%C3%AB-zyr%C3%ABn-e-inspektorit-t%C3%AB-lart%C3%AB-t%C3%AB-drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

¹⁸ I aksesueshëm në linkun vijues: <https://klp.al/2024/10/28/njoftim-per-shprehje-interesi-per-komandimin-e-l-nje-prokurori-prane-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë-permes-procedures-se-komandimit-te-prokuroreve/>

¹⁹ I https://klp.al/wp-content/uploads/2025/01/v.nr_.274.pdf

jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, ka filluar procedurën për shpalljen e vendeve vakante për 4 pozicione vakante në pozicionin “Inspektor jomagjistrat”. Në kuadër të këtij procesi janë paraqitur 19 kandidatura, për të cilat është duke u kryer verifikimi i përmbushjes së kriterëve dhe kushteve ligjore për verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve, sipas kërkesave të nenit 209, pika 6 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 536, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistrat për pozicionin e inspektorit”.

3. Ndërmarrjen e masave të rregullta për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të procesit të rivlerësimit, veçanërisht për inspektorët jomagjistrat.

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar, pasi është pjesë e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky proces ashtu si edhe në vitet e kaluara, ndjek dhe zbaton kushtet dhe kriteret ligjore si dhe mbështetet në bashkëpunimin me institucione të tjera të specializuara.

Procesi i verifikimit të kontrollit e figurës dhe të pasurisë/integritetit, që realizohet në kuadër të procedurës së rekrutimit të inspektorëve jomagjistrat, konsiston në 3 shtylla të cilat për të cilat kryhet verifikim i plotë dhe gjithëpërfshirës për secilin kandidat, lidhur me:

- kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë, të interesave private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe të personave të lidhur;
- verifikimin e pastërtisë së figurës;
- verifikimin e kriterëve ligjore për vlerësimin e profesionalizmit të kandidatit.

Kushtet dhe kriteret ligjore janë të përcaktuara në nenin 209, pika 6 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ndërsa procedura e verifikimit është ajo e përcaktuar nga parashikimet e vendimit nr. 536, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”. Sa i takon kriterëve të vlerësimit të anës profesionale të kandidatit, zbatohen kriteret e përcaktuara për kandidatët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe rregullat e përcaktuara në urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020 “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””.

Për kryerjen e verifikimeve, ILD bashkëpunon me institucione të ndryshme, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokurorinë, organeve publike financiare, Byronë Kombëtare të Hetimit, shërbimeve shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e mëparshme të punës së kandidatit. Nëse vlerësohet e nevojshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë informacione shtesë nga institucione të tjera.

Gjatë procedurës së verifikimit, Inspektori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat jomagjistrat, formularët e deklarimeve të plotësuar, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatëve jomagjistrat, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Inspektorit që vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe të kriterëve të tjera ligjore për kandidim.

Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe të kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, Inspektori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me shqyrtimin e çështjes. Nëse vlerëson që kandidati jomagjistrat nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, Inspektori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, pa qenë e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.

Inspektori vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati jomagjistrat nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

- a) deklarinimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë kandidati jomagjistrat;
- b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si dhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Inspektorit.

Për verifikimin e pasurisë, interesave private dhe detyrimet financiare, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kërkon kryerjen e verifikimit të plotë ILDKPKI-së. Në përfundim të verifikimit të kryer nga ILDKPKI-ja, Inspektori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit jomagjistrat dhe të personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike dhe private, sipas kërkesës së tij. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe të nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, Inspektori mund të kërkojë informacione shtesë nga subjektet publike dhe private dhe shpjegime me shkrim nga kandidati jomagjistrat.

Në rastin kur në procedurën e verifikimit të pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklarinimet e kandidatit jomagjistrat, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga subjektet publike

e private, Inspektori ka të drejtën të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse. Ekspertët e fushës përkatëse të institucioneve shtetërore thirren nga Inspektori sipas fushës së njohurive. Në rastet kur ekspertiza nuk mbulohet nga institucionet shtetërore, ekspertët përzgjidhen nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuara për fushën përkatëse.

ILD ka zhvilluar 2 procedura rekrutimi në vitet 2020 dhe 2021, për të cilat ka pasur kandidatë që u është ndaluar kandidimi për shkak të mosplotësimit të kriterit të pasurisë, pas evidentimit nga raporti i ILDKPKI-së. Për të gjitha rastet është proceduar me vendimet respektive të ndalimit. Raportet për rastet e tjera të pranimit apo të ndërprerjes, gjenden të publikuara, bashkë me arsyetimin përkatës, në faqen zyrtare të ILD-së.

Nga kandidaturat e paraqitura nuk ka pasur asnjë rast për kandidatë të dorëhequr gjatë procedurës së rivlerësimi apo që të jenë shkarkuar për shkak të procesit të rivlerësimit.

Ky rekomandim përkon edhe me masat e evidentuara në kuadër të Raportit të Shtetit të së Drejtës të Bashkimit Evropian i cili kërkon zbatim të verifikimit të plotësimit të kriterëve dhe kushteve ligjore, në përputhje me standardet e larta të vettingut. Në lidhje me këtë rekomandim nga ana e ILD-së është kërkuar vënia në dispozicion e standardeve për t'u vlerësuar dhe për t'u përfshirë në praktikën e brendshme të punës.

4. Rritja e numrit të inspektimeve institucionale me objektiv të qartë dhe të përcaktuar, të fokusuara në aspektet specifike të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorisë për menaxhimin e çështjeve dhe administrimin gjyqësor dhe hetimor.

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar. Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorisë dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e paraqitur me shkrim nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrisë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Në funksion të këtij qëllimi janë hartuar kërkesat drejtuar institucioneve të parashikuara në nenin 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, lidhur me planifikimin e inspektimeve për vitin 2024 duke kërkuar dhënien e propozimeve për tematika inspektimi.

Me shkresën nr. 3370/1, datë 13.12.2023, i është kërkuar informacion Prokurorit të Përgjithshëm për përcjelljen e propozimeve për tematika inspektimi. Prokurori i Përgjithshëm ka kthyer përgjigje përmes shkresës nr. 1854/1 prot., datë 26.12.2023, ku propozon inspektime tematike me objekt:

1. Respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimave të krimeve seksuale dhe dhunës në familje;
2. Zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale; zbatimin e masave të sigurimit dhe dënimit për të mitur.

Me shkresën nr. 3370/2, datë 13.12.2023, i është kërkuar informacion Këshillit të Lartë Gjyqësor për përcjelljen e propozimeve për tematika inspektimi. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kthyer përgjigje përmes shkresës nr. 6395/1 prot., datë 14.12.2023, ku krahas çështjeve të parashikuara në Rezolutën e Kuvendit për veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2023, lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, në vijim do të përcjellë propozime konkrete mbi tematika inspektimi. Në vijim të kësaj shkrese gjatë vitit 2024, nuk kanë ardhur tematika të tjera që lidhen me inspektimet.

Me shkresën nr. 3370/3, datë 13.12.2023, i është kërkuar informacion Këshillit të Lartë të Prokurorisë për përcjelljen e propozimeve për tematika inspektimi, por nga ana e këtij këshilli nuk ka pasur tematika të propozuara.

Me shkresën nr. 3370/4, datë 13.12.2023, i është kërkuar informacion Ministrisë së Drejtësisë për përcjelljen e propozimeve për tematika inspektimi. Ministria e Drejtësisë ka kthyer përgjigje përmes shkresës nr. 6925/1 prot., datë 27.12.2023, ku propozon inspektim tematik me objekt:

1. Zvarritje të proceseve gjyqësore dhe mosdorëzim në kohë i vendimeve të arsyetuara në afat së bashku me dosjen gjyqësore, problematikë e cila shtrihet në të gjitha gjykatat e vendit.

Në vijim të kërkesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas analizimit të tematikave dhe kapaciteteve për realizimin e tyre, ka miratuar planin e inspektimeve për vitin 2024, me këto tematika:

1. “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli elektronik i raporteve të sistemit elektronik për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.05.2024 – 31.12.2024;
2. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.05.2024 – 31.12.2024;
3. “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.05.2024 – 31.12.2024;
4. “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore për periudhën 01.03.2023 – 31.05.2023”, me periudhë realizimi 15.04.2024 – 02.12.2024;
5. “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023”, me periudhë realizimi 01.04.2024 – 30.09.2024;
6. “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”, me periudhë realizimi 15.02.2024 – 29.03.2024.

Në krahasim me numrin e inspektimeve të planifikuara për vitin 2023, plani i vitit 2024 përmban 2 tematika të shtuara, si rezultat i bashkëpunimit mes Ministrisë së Drejtësisë, që

kanë për qëllim rritjen e efencës së sistemit gjyqësor, të cilat kanë gjetur reflektim në planin e inspektimeve për vitin 2024. Gjithashtu ndërmarrja e inspektimit tematik “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore”, ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë.

Nga të dhënat e administruara në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ankesave, me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është ndryshuar plani i inspektimeve tematike, duke shtuar një tematike të re, atë të kohëzgjatjes së gjykimit të çështjeve gjyqësore, duke pasur në vëmendje çështje të rritjes së cilësisë dhe efencës së sistemit gjyqësor, si prioritet ndaj pretendimeve të publikut.

Nga ana tjetër, në zbatim të këtij rekomandimi, janë marrë masa duke përfshirë në planin vjetor të inspektimeve për vitin 2025, një inspektimin institucional, me objekt kontrollin e aspekteve specifike të veprimtarisë në administrimin e dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari e deri në përfundimin e trajtimit të tij. Ky inspektim do të kryhet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

5. Përfundimi i vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve në një kohë të arsyeshme dhe rezultatet e vlerësimit të përdoren për të zhvilluar programe trajtimi në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale.

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar. Më datë 05.01.2024, është mbajtur mbledhja e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit (KEV), në kuadër të së cilës u diskutua programi i vlerësimit dhe u vendos për vijimin e vlerësimit të dy inspektorëve jomagjistratë dhe u zhvillua edhe shorti për përzgjedhjen e relatorit për të realizuar procedurën e vlerësimit, duke vijuar me nxjerrjen e vendimeve:

1. Nr. 1, datë 05.01.2024 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorit jomagjistrat A. T., për periudhën 05.02.2021 – 04.02.2023”;
2. Nr. 2, datë 05.01.2024 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorit jomagjistrat J. S., për periudhën 05.02.2021 – 04.02.2023”.

Me vendimin nr. 56, datë 10.12.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa shtesa në vendimin nr. 38, datë 08.06.2021 “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”, të ndryshuar”, është reduktuar perioda e vlerësimit duke përcaktuar afat 1 vjeçar të punës së inspektorit. Qëllimi i ndryshimit të periudhës, i përgjigjet nevojës për të përshpejtuar procesin e vlerësimit, për pjesën tjetër të inspektorëve.

Në vijim të procesit të vlerësimeve KEV në mbledhjen e datës 11.12.2024, ka zhvilluar shortin për përzgjedhjen e relatorit përgjegjës për të realizuar procedurën e vlerësimit për secilin nga inspektorët të cilët janë objekt vlerësimi, duke vijuar me nxjerrjen e vendimeve:

1. Nr. 57, datë 11.12.2024 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorit jomagjistrat A. K., për periudhën 07.11.2022 – 06.11.2023 dhe 07.11.2023 – 06.11.2024;
2. Nr. 58, datë 11.12.2024 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorit jomagjistrat E. N., për periudhën 18.10.2022 – 17.10.2023 dhe 18.10.2023 – 17.10.2024;
3. Nr. 59, datë 11.12.2024 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorit jomagjistrat J. S., për periudhën 05.02.2023 – 04.02.2024.

Në kuadër të këtyre vendimeve KEV ka vijuar me vlerësimin e inspektorëve, duke e rritur numrin e vlerësimeve në 5 inspektorë të vlerësuar.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, nuk ka qenë i nevojshëm zhvillimi i programeve të trajnimit në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale. Por ky rekomandim do të jetë në vëmendje të Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit gjatë zhvillimit të procedurave vijuese të vlerësimit.

6. *Angazhimi për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit në hetime dhe inspektime tematike, si dhe koordinimin e veprimeve për të adresuar çështje të përbashkëta.*

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar. Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rritja e bashkëpunimit është në fokus të ushtrimit të veprimtarisë e për pasojë, kërkesat e ardhura nga Ministria e Drejtësisë, janë bërë shkak edhe për fillimin e hetimit disiplinor ndaj një magjistrati gjyqtar. Gjithashtu, sikundër është informuar në rekomandimin nr. 4, të Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e vitit 2023, në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë janë përfshirë në planin e inspektimeve vjetore dy tematika të propozuara nga ky institucion, konkretisht:

- “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”.
- “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 01.01.2023 – 01.06.2023”.

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera të drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka bërë thirrje të vazhdueshme për tryeza të përbashkëta midis organeve të sistemit të drejtësisë, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në tryeza me Komisionin Evropian (Konferenca Ndërqeveritare BE – Shqipëri, Bruksel nëntor 2022; Takimi i 14-të i JFS mars 2024), për të zhvilluar takime pune vjetore për të diskutuar çështje që dalin nga veprimtaria e institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke vënë theksin në dialogun dhe forcimin e bashkëpunimit. Si rezultat, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Mbajtja e një tryeze të rrumbullakët në qershor të vitit 2024 ndërmjet përfaqësuesve të KLGJ-së, KLP-së dhe KLGJ-së për rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë, me fokus të veçantë në vlerësimin e vazhdueshëm të gjyqtarit dhe prokurorit.

- Me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në dhjetor 2024 u zhvillua një mbledhje pune në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Qëllimi i takimit ishte adresimi i sfidave që lidhen me komunikimin institucional dhe forcimi i mëtejshëm i sinergjisë së bashkëpunimit mes dy institucioneve për një sistem drejtësie efikas dhe më të qëndrueshëm. Pjesë e diskutimeve ishin edhe inspektimet tematike dhe institucionale, standardizimi i disiplinës në punën e magjistratëve, si dhe trajtimi i rasteve që kërkojnë ndërhyrje emergjente. Në takim u theksua nevoja për standardizimin e marrëdhënieve mes drejtuesve të prokurorive/gjykatave dhe magjistratëve, duke kapërcyer çështje që ligji nuk i qartëson, me profesionalizëm dhe bashkëpunim institucional. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë vlerësuan marrëdhënien mes dy institucioneve si korrekte dhe të bazuar në respektimin e ligjit. Ata theksuan rëndësinë e vazhdimin të këtij bashkëpunimi për të ruajtur besimin e publikut dhe standarde të larta etike dhe profesionale.

7. Përmirësimi i treguesve të transparencës dhe aksesueshmërinë e publikut duke publikuar informacione periodike, raporte dhe çdo të dhënë tjetër që reflekton veprimtarinë institucionale.

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar. Për vitin 2023, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka publikuar “Indeksin e transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë renditet i pari, si institucioni që i ka të gjithë treguesit pozitivë, duke grumbulluar 10 pikë nga 10 të mundshme për “një transparencë proaktive të lartë”, ndjekur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit^[20]. Edhe në “Indeksin e transparencës së institucioneve qendrore dhe të varësisë” për vitin 2024^[21], edhe pse nuk ka një rankim numerik si një vit më parë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vlerësuar me pikët maksimale, 12 pikë, në 12 fushat e vlerësimit, që nisin me transparencën e institucionit.

Duke vlerësuar edhe ekspertizën e metodologjinë e këtij institucioni publik, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar edhe gjatë vitit 2024 të ketë në vëmendje raportin me qytetarin, së pari si ankues për shkelje disiplinore të pretenduara ndaj gjyqtarëve e prokurorëve dhe së dyti si qytetar i informuar, përmes aktiviteteve për edukim ligjor me grupe të ndryshme shoqërore, duke i pasqyruar si gjithmonë në faqen zyrtare të institucionit.

²⁰https://idp.al/wpcontent/uploads/2024/03/2023_Indeksi_i_transparences_autoritete_qendrore_varesia.pdf

²¹<https://idp.al/wp-content/uploads/2025/02/Indeksi-i-Transparences-proaktive-te-institucioneve-qendrore-dhe-te-varesise-viti-2024.pdf>

Bazuar në komunikimin e vazhdueshëm publik, jo vetëm me qytetarë por edhe me grupe shoqërore, faqja ka pësuar përmirësime në pjesën e paraqitjes së ankesës dhe në zhvendosjen në pjesë më të dukshme, të rubrikave mbi aktet, strategjitë, inspektimet tematike e marrëveshjet e ILD-së, për një akses krejt të thjeshtuar për çdo përdorues të faqes sonë të internetit.

Faqja është dygjuhëshe, në shqip e anglisht dhe përmban informacion të shkruar dhe vizual, sipas rastit, për çdo aspekt të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke konsideruar vlerësimin e bërë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, vlerësojmë se ekspertiza dhe metodologjia e përdorur deri tani është e saktë dhe duhet të vijojë të zbatohet më tej duke shfrytëzuar çdo hapësirë të re për përmirësim.

8. *Angazhimi në përmbushjen me efektivitet të plotë të gjitha detyrimet institucionale në kuadër të raportimeve, duke kontribuar në kohë në raportimet në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.*

Rekomandimi konsiderohet i plotësuar. Në funksion të këtij rekomandimi që përbën detyrë funksionale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përmbushur me efektivitetet të gjitha detyrimet në kuadër të raportimeve në kuadër të procesit të integritetit duke marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet:

- Nënkomiteti BE – Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri, në Bruksel, 20 mars 2024.
- Takimet bilaterale për shtetin e së drejtës, Bruksel 21 mars 2024.
- Këshillit Kombëtar i Integritetit Evropian.
- Tryezat e organizuara nga Ministri i Drejtësisë në kuadër të pozicionit të përbashkët, i BE-së.

Ndërkohë që në nivel teknik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcaktuar dy punonjës për të ndjekur dhe marrë pjesë në të gjitha takimet raportuese e koordinuese, për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, të cilët kanë ndjekur të gjitha takimet me prezencë dhe *online* në kuadër të angazhimeve të Kapitullit 23, duke dhënë kontribut lidhur me:

- Progres Raportin për Shqipërinë.
- Raportin për Shtetin e së Drejtës të BE-së.
- Piketat e Ndërmjetme në kuadër të Pozicionit të përbashkët të BE-së.
- Përditësimet e të dhënave për periudha të ndryshme raportimi.

Nisur nga zhvillimet e rëndësishme në drejtim të integritetit evropian që po kalon vendi këto dy vitet e fundit, por edhe nga avancimi i hapjes së negociatave për kapituj të ndryshëm, ku ndër më të rëndësishmit, edhe hapja e negociatave për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, është bërë një analizë e brendshme e shpërndarjes së funksioneve të administratës dhe është vlerësuar se nevojitet një ridimensionim i prioritetëve të punës dhe

një rishpërndarje të burimeve njerëzore aktuale në drejtim të përqendrimit të kapacitetit njerëzor në ato procese pune ku dinamika është e lartë, e ndryshueshme dhe kërkon koordinim të mirë, si në nivel të brendshëm me organe dhe institucione bashkërenduese në procesin e integritetit, po ashtu edhe me aktorë ndërkombëtarë.

Duke vlerësuar ndryshimet e 6-mujorit të dytë të vitit 2024, intensifikimi i proceseve raportuese përkundrejt Ministrisë së Drejtësisë por edhe organeve të tjera që kanë rol në procesin e integritetit, janë analizuar disa procese të punës së njërive organizative të administratës për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të ILD-së për të qenë më proaktiv në tryeza dhe me kontribute të plota dhe në kohën e duhur. Propozime konkrete janë paraqitur pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në funksion të riorganizimit të proceseve të brendshme.